Qera operacionale nga ALBtelecom Sh.a.	8,467	2,166
Shpenzime operative:		
ALBtelecom Sh.a., Eagle Mobile Sh.a. dhe Calik Holding	(113,006)	(120,622)
Neto	**98,133**	**81,888**

Veprime me drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë

Shpërblimi i drejtorëve dhe drejtuesve ekzekutivë përfshihet tek shpenzimet e personelit. Detajet paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Drejtorët	13,624	12,537
Drejtuesit ekzekutivë	328,740	285,244
	342,364	**297,781**

Më 31 dhjetor 2014, depozitat totale të drejtorëve pranë Bankës ishin 94,727 mijë Lek (31 dhjetor 2013: 103,433 mijë Lek), dhe nuk ka teprica huash të dhëna drejtorëve.

34. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë sistemime ose shpjegime shtesë tek pasqyrat financiare të konsoliduara.

PERMBLEDHJA E PARIMEVE KONTABEL PER PERGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN 2014

Respektimi i standarteve

Pasqyrat financiare të konsoliduara shoqëruese janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF"), e miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" ("Ligji për Bankat").

Përmbledhja e parimeve kontabël

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të shprehura në Lek, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt, nëse nuk është shënuar ndryshe dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç se për letrat me vlerë të vendosjes, të cilat llogariten me vlerën e tregut.

Parimet kontabël të zbatuara nga Banka, janë të njëjta me ato përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013.

Baza e konsolidimit

(i) Filialet

Filialet janë njësi (degë) të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi mbi një njësi, është e ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj tek njësia, dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në përfitimet e njësisë.

Konsolidimi i një filiali fillon nga momenti kur Banka merr kontrollin mbi filialin dhe ndalon kur Banka humb kontrollin e filialit. Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali, të blerë apo shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve nga data kur Banka mer kontrollin deri në datën kur Banka humbet kontrollin mbi njësinë.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur politika kontabël të njëjta për transaksione të njëjta dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.

Më 3 shtator 2007, BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në qytetin e Prishtinës, Kosovë.

(ii) Transaksionet e eleminuara gjatë konsolidimit

Të gjitha aktivet dhe detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe rrjedhjet e parasë (përveç fitimeve dhe humbjeve nga transaksionet në monedhë të huaj) të lidhura me transaksionet ndërmjet anëtarëve të Grupit janë eleminuar plotësisht në konsolidim. Humbjet e parealizuara janë eleminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për humbje të vlerës.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë kthyer me kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni. Aktivet dhe detyrimet monetare, të shprehura në monedhë të huaj, të cilat kontabilizohen me koston historike në datën e transaksionit, janë këmbyer sipas kursit të këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare, të shprehura në monedhë të huaj, në vlerën e tyre historike, rivlerësohen me kursin e këmbimit në datën kur është bërë transaksioni. Diferencat që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave të aktiveve e detyrimeve monetare janë njohur në pasqyrën e të ardhurave tek "Fitimi (humbja) nga rivlerësimi i valutave, neto".

Kapitali i paguar është trajtuar si një zë monetar dhe është rivlerësuar në përputhje me parimin e shpjeguar më sipër. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, kapitali në monedhë të huaj duhet të paraqitet në bilanc i konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit dhe një "rezervë rivlerësimi" e krijuar në kapitalin e aksionarëve që përfaqëson diferencën në Lek ndërmjet kursit të fundit të periudhës me kursin historik që përdoret për të regjistruar kapitalin e paguar në monedhë të huaj.

Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore, subjekt i një rreziku jo domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore mbahen në bilancin kontabël të konsoliduar me kosto të amortizuar.

Depozita dhe llogaritë me bankat

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë depozita ndërbankare dhe zëra që janë në proçesin e arkëtimit.

Bonot e thesarit

Bonot e thesarit janë klasifikuar në dy kategori si aktive të vendosjes ose deri në maturim dhe regjistrohen fillimisht me kosto plus interesin e përllogaritur. Bonot e thesarit janë klasifikuar duke u bazuar në qëllimin dhe aftësinë e Bankës për t'i mbajtur deri në maturitet.

Letrat me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje. Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në çmimin e tregut, me interesin e përllogaritur për kuponat për t'u paguar. Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e transferimit përllogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë. Letrat me vlerë të vendosjes, pas regjistrimit të tyre fillestar rimaten me vlerën e tregut dhe humbjet që shkaktohen nga ndryshimi i vlerës së tregut të letrave të vendosjes përfshihen tek fitimi dhe humbja neto për periudhën përkatëse. Këto letra me vlerë konsiderohen si të vendosjes pasi Banka ka si qëllim shitjen e tyre përpara datës së maturimit.

Letrat me vlerë të investimit

Letrat me vlerë të investimit që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet fiks, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë te drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, me interesin e përllogaritur për kuponat për t'u paguar. Çdo skonto ose prim i paguar mbi vlerën nominale në momentin e blerjes përllogaritet deri në datën e pagesës së principalit të letrës me vlerë.

Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë dhe paradhëniet për klientët raportohen mbi vlerën e tyre neto me provigjonin e humbjeve specifike nga huatë. Provigjonet krijohen në zbatim të rregullores Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" (Rregullorja e kredisë) e miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës datë 14 shtator 2011. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë huatë e saj në gjashtë kategori rreziku. Për çdo kategori rreziku, janë zbatuar normat e mëposhtme të provigjoneve:

Lloji i huasë	*Ditë vonese për overdraftet*	*Ditë vonese për huatë me afat*	*Norma e provigjonit*
Standarte	0 ditë	0 ditë	1%
E pakthyer në afat	1-30 ditë	1-30 ditë	1%
Në ndjekje	31-60 ditë	31-90 ditë	5%
Nënstandarte	61-90 ditë	91-180 ditë	20%
E dyshimtë	91-180 ditë	181-365 ditë	50%
E humbur	Mbi 180 ditë	Mbi 365 ditë	100%

Provigjonet për humbje nga huatë për degën e Kosovës janë krijuar në bazë të Rregullës "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" (e ndryshuar), miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës më 9 nëntor 2012. Normat minimale të provigjonit të aplikuara nga dega për çdo kategori janë të njëjta me ato të aplikuara në Shqipëri.

Huatë dhe paradhëniet për klientët raportohen mbi vlerën e tyre neto me provigjonin e humbjeve specifike nga huatë e klasifikuara si nënstandarte, të dyshimta dhe të humbura. Provigjonet e krijuara për humbje të mundshme nga huatë e klasifikuara si standarde, të pakthyera në afat dhe në ndjekje janë regjistruar si provigjone statistikore në anën e detyrimeve të bilancit. Për informacion të detajuar mbi huatë dhe paradhëniet për klientët referojuni shënimeve 9 dhe 15.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat (vazhdim)

Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhjet e ardhshme të parasë duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra të cilat janë një pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet rrjedhin nga shërbimet financiare që ofrohen nga Banka, si transferime fondesh, mbajtjen e llogarive, aktivitetet e huadhënies dhe të tregtimit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv. Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera nga komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

Tatimi mbi fitimin

Banka përcakton shumën e tatueshme në fund të vitit në përputhje me legjislacionin shqiptar të tatimeve. Në vitin 2014, tatimi mbi fitimin është i barabartë me 15% (2013: 10%) të fitimit të tatueshëm. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke modifikuar fitimin para tatimit për zëra të caktuar të ardhurash dhe shpenzimesh në përputhje me legjislacionin shqiptar. Fitimi përpara tatimit bazohet mbi regjistrimet financiare të mbajtura nga Banka për qëllime rregullatore në përputhje me MRF dhe mund të ndryshojë ndjeshëm nga rezultati financiar i raportuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Shiko shënimin 32. Për më tepër, MRF nuk kërkon që Banka të masë dhe të regjistrojë aktivet dhe detyrimet e shtyra.

Në përcaktimin e shumës së tatimit të vitit Banka merr në konsideratë efektin e disa pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse do ketë detyrime për tatime apo interesa shtesë. Banka beson se shpenzimet e saj të përllogaritura për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjithë vitet tatimore duke e bazuar vlerësimin e saj në shumë faktorë, përfshirë dhe interpretimin e legjislacionit tatimor dhe përvojat e mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë disa gjykime për ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të ditura, mund të bëjnë që Banka të ndryshojë vlerësimin e saj për përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën që bëhet përcaktimi.

Plani i pensionit

Banka ka krijuar një fond për planin e pensionit (Programi Mbështetës për Stafin – 'SSP') i sponsorizuar tërësisht nga punëdhënësi (shiko shënimin 15 "Fondi rezervë për punonjësit që do të dalin në pension") në vitin 2002. Shuma që do të regjistrohej tek ky fond vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit. Gjatë vitit, shuma e përllogaritur regjistrohej tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve tek fondi në bazë mujore. Shumat që Banka i detyrohet punonjësve në bazë të planit të mësipërm do të rriten me të ardhura bruto nga interesi nga data që punonjësi largohet nga Banka deri në momentin e daljes në pension. Shumat do t'u paguhen punonjësve vetëm kur ata arrijnë moshën e pensionit sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me një minimum prej 75% të pensionit të tyre shtetëror mujor derisa fondi i akumuluar për punonjësit konsumohet.

Bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues, të hyrë në fuqi më 30 shtator 2010, Banka ka ndërprerë investimin në fondin SSP, duke e transformuar atë në Programin e Kreditimit të Qëndrueshmërisë së Stafit ('SRCP'). Shuma e llogaritur për secilin punonjës përfitues nga SSP u ngurtësua në të njëjtën ditë. Shuma e ngurtësuar dhe interesi përkatës vjetor që do të gjenerohet nga investimi në të ardhmen në letra me vlerë të klasifikuara AAA deri në daljen në pension të punonjësit, do t'i shtohet fondit të investimit nga ana e Bankës.

Aktive të qëndrueshme dhe rregullim i ambienteve me qera

Pronat dhe pajisjet janë të shprehura në kosto minus amortizimin e akumuluar, i cili është llogaritur me mënyrën lineare mbi jetën e përdorimit të vlerësuar për këto aktive.

Toka nuk amortizohet.

Amortizimi është llogaritur në përputhje me normat e mëposhtme:

Ndërtesa dhe rregullimi i ambienteve me qera	5%
Mjete transporti	20%
Pajisje dhe mobilim zyre	20%
Pajisje TI dhe elektronike	25%
Pajisje	20%

Veprimet spot të këmbimit valutor

Banka gjatë aktivitetit normal të punës kryen veprime spot të këmbimit valutor, me data shlyerje pas një ose dy ditësh pas datës së transaksionit. Këto transaksione regjistrohen tek zërat jashtë bilancit në datën e transaksionit dhe njihen në datën e shlyerjes së transaksionit.

Me respekt,

Skënder EMINI
Drejtor i Grupit të Financës dhe TI

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Raporti i auditorit të pavarur dhe
pasqyrat financiare të konsoliduara
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

Përmbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA:	
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	**1**
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE	**2**
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	**3-4**
PASQYRA E KONSOLIDUAR E RRJEDHËS SË PARASË	**5**
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA	**6 – 61**

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
www.deloitte.al

VAT (NUIS) No: L41709002H

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionarit dhe Drejtimit të Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur, të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. të cilat përmbajnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar mbi auditimin tonë. Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke marrë parasysh edhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara, në mënyrë që të përcaktojë proçedura auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë bazë të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të kualifikuar të auditimit.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Baza për Opinionin e Kualifikuar

Siç është shpjeguar në shënimin 3 (b), Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. e ka trajtuar kapitalin e saj aksionar të lëshuar në Dollar Amerikan (USD) si një zë monetar në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe ka njohur në fitim humbjen neto në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, diferencat që rezultojnë nga konvertimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014. Ky trajtim nuk është në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 21 "Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit", i cili kërkon që kapitali aksionar të trajtohet si një zë jo-monetar dhe të mbahet me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Nëse kapitali aksionar do të ishte trajtuar si një zë jo-monetar dhe do të ishte mbartur me kursin e këmbimit të datës kur kontributet në kapitali janë bërë, fitimi neto do të ishte rritur me 17,282,439 USD dhe diferenca nga konvertimi në monedhë të huaj do të ishte ulur me 1,339,023 USD për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014. Përkatësisht, kapitali aksionar dhe rezerva e konvertimit më 31 dhjetor 2014 do të ishin ulur me 15,943,416 USD dhe 1,339,023 USD dhe fitimi i mbartur do të ishte rritur me 17,282,439 USD. Rrjedhimisht, kjo nuk do të kishte ndikuar mbi totalin e kapitalit të aksionarëve.

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së trajtuar në paragrafin Baza për Opinionin e Kualifikuar, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. më 31 dhjetor 2014, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
24 shkurt 2015
Tiranë, Shqipëri

Elvis Ziu
Partner Angazhimi

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Ad.Rr.Ebasanit,Pll.nr1,kt2,pshte Fakultetit Gjeologji Minieria
Tel:044517920
NIPT: L41709002H TIRANA - ALBANIA

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014

(shprehur në USD)

	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktivet			
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	7	227,950,918	237,473,002
Depozita dhe llogari me bankat	8	139,345,055	201,279,874
Bono thesari	9	276,418,401	236,724,368
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	10	745,191,900	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	11	198,822,024	217,755,420
Hua për bankat	12	173,290,510	121,650,866
Hua për klientët	13	920,268,253	886,202,417
Investime në pjesëmarrje	14	1,458,925	1,651,128
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	15	24,183,398	27,942,467
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	16	1,230,590	1,235,689
Aktive të tjera	17	44,460,622	46,647,434
Totali i aktiveve		**2,752,620,596**	**2,675,742,240**
Detyrimet dhe kapitali aksionar			
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	18	2,140,818,985	2,154,265,396
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	19	326,914,452	278,355,823
Detyrime ndaj palëve të treta	20	2,123,604	1,738,013
Detyrime tatimore të shtyra	21	1,846,611	3,264,859
Detyrime të tjera	22	15,994,899	9,355,434
Borxhi i varur	23	18,287,260	13,796,864
Totali i detyrimeve		**2,505,985,811**	**2,460,776,389**
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar i paguar	24	166,403,900	138,965,905
Rezerva e konvertimit	24	(3,403,714)	1,140,491
Rezerva e vlerës së drejtë	24	(3,835,505)	(3,196,237)
Fitimi i pashpërndarë	24	87,470,104	78,055,692
Totali i kapitalit aksionar		**246,634,785**	**214,965,851**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		**2,752,620,596**	**2,675,742,240**

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyrat financiare të konsoliduara u autorizuan nga Këshilli Drejtues më 27 janar 2015 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Seyhan Pencabligil
Drejtor i Përgjithshëm dhe
Anëtar i Këshillit Drejtues

Skënder Emini
Drejtor i Grupit të Financës
dhe TI

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(shprehur në USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Interesi			
Të ardhura nga interesi	25	143,762,664	151,939,082
Shpenzime interesi	26	(53,933,307)	(75,024,078)
Të ardhura nga interesi, neto		**89,829,357**	**76,915,004**
Të ardhura të tjera, neto nga veprimtaria bankare			
Tarifa dhe komisione, neto	27	11,631,888	9,557,408
(Humbja)/fitimi neto nga rivlerësimi i instrumentave monetare	28	5,623,813	(4,035,425)
Humbja neto nga këmbimet valutore		(6,102,286)	(1,623,197)
(Humbja)/fitimi neto nga tregtimi i investimeve		(1,189,395)	1,645,526
Të ardhura të tjera, neto	29	3,853,025	10,743,743
Totali i të ardhurave të tjera neto nga veprimtaria bankare		**13,817,045**	**16,288,055**
Shpenzime operative			
Shpenzime personeli	30	(18,612,881)	(17,105,138)
Shpenzime administrative	31	(22,790,078)	(20,974,604)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	15,16,17	(4,838,625)	(5,090,334)
Totali i shpenzimeve operative		**(46,241,584)**	**(43,170,076)**
Zhvlerësimi i huave	13	(4,529,160)	(6,199,500)
Fitimi para tatimit		**52,875,658**	**43,833,483**
Tatimi mbi fitimin	32	(8,944,762)	(4,530,730)
Fitimi neto i vitit		**43,930,896**	**39,302,753**
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja		(4,544,205)	746,300
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së tregut		(639,268)	(10,042,202)
Shpenzime të tjera përmbledhëse për vitin, neto pas tatimit		**(5,183,473)**	**(9,295,902)**
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		**38,747,423**	**30,006,851**

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar i paguar	Rezerva Ligjore	Rezerva e konvertimit	Rezerva e vlerës së tregut	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2013	**100,000,000**	**3,410,723**	**394,191**	**6,845,965**	**73,652,910**	**184,303,789**
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital						
Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët						
Rritja e kapitalit aksionar	38,965,905	(3,282,146)	-	-	(35,683,759)	-
Rregullimi i diferencave të rivlerësimit të rezervës ligjore		(128,577)			128,577	-
Kthimi i diferencave të konvertimit të vitit 2012	-	-	-	-	394,191	394,191
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2013	-	-	-	-	261,020	261,020
Totali i veprimeve me pronarët të regjistruar direkt në kapital	*38,965,905*	*(3,410,723)*	-	-	*(34,899,971)*	*655,211*
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin						
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	39,302,753	39,302,753
Të ardhura/(humbje) të tjera përmbledhëse, neto pas tatimit						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së tregut	-	-	-	(10,042,202)	-	(10,042,202)
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	746,300	-	-	746,300
Totali i të ardhurave/(humbjeve) të tjera përmbledhëse	-	-	746,300	(10,042,202)	-	(9,295,902)
Totali i të ardhurave (humbjes) përmbledhëse për vitin	-	-	*746,300*	*(10,042,202)*	*39,302,753*	*30,006,851*
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**138,965,905**	**-**	**1,140,491**	**(3,196,237)**	**78,055,692**	**214,965,851**

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(shprehur në USD)

	Kapitali aksionar i paguar	Rezerva Ligjore	Rezerva e konvertimit	Rezerva e vlerës së tregut	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2014	**138,965,905**	**-**	**1,140,491**	**(3,196,237)**	**78,055,692**	**214,965,851**
Veprimet me pronarët të regjistruara direkt në kapital						
Totali i kontributeve nga pronarët dhe shpërndarjeve për pronarët						
Krijimi rezerves ligjore	-	7,355,870	-	-	(7,355,870)	-
Rritja e kapitalit aksionar	27,437,995	(6,867,867)			(20,570,128)	-
Rregullimi i diferencave të rivlerësimit të rezervës ligjore	-	(488,003)			488,003	-
Kthimi i diferencave të konvertimit të vitit 2013	-	-	-	-	1,140,491	1,140,491
Rregullimi i fitimit të pashpërndarë me kursin e fund vitit 2014	-	-	-	-	(8,218,980)	(8,218,980)
Totali i veprimeve me pronarët të regjistruara direkt në kapital	*27,437,995*	-	-	-	*(34,516,484)*	*(7,078,489)*
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin						
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	43,930,896	43,930,896
Të ardhura/(humbje) të tjera përmbledhëse, neto pas tatimit						
Ndryshimet neto në rezervën e vlerës së tregut	-	-	-	(639,268)	-	(639,268)
Diferenca konvertimi të monedhave të huaja	-	-	(4,544,205)	-	-	(4,544,205)
Totali i të ardhurave/(humbjeve) të tjera përmbledhëse	-	-	(4,544,205)	(639,268)	-	(5,183,473)
Totali i të ardhurave (humbjes) përmbledhëse për vitin	-	-	*(4,544,205)*	*(639,268)*	*43,930,896*	*38,747,423*
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**166,403,900**	**-**	**(3,403,714)**	**(3,835,505)**	**87,470,104**	**246,634,785**

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(shprehur ne USD)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Rrjedha e parave nga aktivitetet operacionale:			
Fitimi para tatimit		52,875,658	43,833,483
Rregullime për të barazuar ndryshimet në aktivet neto me rrjedhën neto të parave nga aktivitetet operacionale:			
Shpenzime interesi	26	53,933,307	75,024,078
Të ardhura nga interesi	25	(143,762,664)	(151,939,082)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	15,16,17	4,838,625	5,090,334
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara		(98,341)	(25,936)
Fitimi nga shitja e bonove të thesarit		(36,380)	(168,018)
Fitimi nga shitja e aktiveve të fituara me proçes ligjor		(31,336)	(95,933)
Fitimi nga arkëtimi i kredive të fshira të klientëve		(15,633)	(40,425)
Nxjerrje jashtë përdorimit e aktiveve të trupëzuara		40,738	2,594
Fshirja e kredive të klientëve		157,905	24,068
Lëvizje në rezervën e vlerës së drejtë		(1,103,494)	(9,939,563)
Provizione për humbjet nga huatë	13	4,529,160	6,199,500
Rrjedha e parave nga fitimet operacionale para ndryshimeve në aktive dhe detyrime operacionale		(28,672,455)	(32,034,900)
(Rritja)/ Pakësimi i aktiveve operacionale:			
Llogaritë e kufizuara me bankën qendrore		(908,538)	(514,566)
Depozita dhe llogari me bankat		(18,452,992)	(10,704,937)
Hua për bankat		(71,846,843)	74,438,070
Hua për klientët		(154,791,482)	(3,875,408)
Aktive të tjera		(4,627,968)	(21,383,389)
		250,627,823	37,959,770
Rritja/ (Pakësimi) i detyrimeve operacionale:			
Detyrime ndaj klientëve		267,079,542	188,495,231
Detyrime ndaj palëve të treta		641,533	(577,864)
Detyrime të tjera		4,523,114	(2,146,658)
Borxhi varur		6,637,277	57,733
		278,881,466	185,828,442
Interesi i paguar		(62,680,759)	(75,022,796)
Interesi i arkëtuar		143,845,750	148,007,896
Tatimi fitimi i paguar		(5,028,856)	(4,980,028)
Rrjedhja neto e parasë nga aktivitetet operacionale		**75,717,323**	**259,758,384**
Rrjedhja e parave nga aktivitetet investuese			
Blerje e investimeve		(143,398,016)	(283,360,513)
Blerje e bonove të thesarit		(105,751,178)	(8,726,332)
Investime në pjesëmarrje		683	(1,591,746)
Blerje e aktiveve të trupëzuara		(5,264,259)	(3,534,302)
Hyrje nga shitja e aktiveve të trupëzuara		896,900	75,601
Hyrje nga shitja e bonove të thesarit		28,666,679	45,312,300
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		**(224,849,191)**	**(251,824,991)**
Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese			
Hyrje nga huatë afatshkurtra		88,386,898	28,848,590
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese		**88,386,898**	**28,848,590**
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		**(60,744,970)**	**36,781,982**
Diferencat në kursin e këmbimit		(10,203,863)	2,192,912
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7	**238,615,381**	**199,640,486**
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7	**167,666,548**	**238,615,381**

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nga faqja 6 deri në faqen 61, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. është një bankë tregtare që ofron një gamë të gjerë me shërbime të plota. Pasqyrat e konsoliduara financiare përfshijnë Bankën dhe degën e saj në Kosovë (referuar së bashku në vazhdim si "Banka", ose "BKT").

Banka ofron shërbime bankare për ndërmarrje shtetërore e private dhe individë. Burimi kryesor i fondeve për Bankën janë depozitat, të cilat Banka i pranon në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozita me dhe pa afat, si në Lek ashtu edhe në valutë. BKT ofron: një shumëllojshmëri të kredive për biznese dhe individë, karta krediti dhe debiti në përputhje me standartin EMV, bankomate, bankingu në internet, bankingu në telefon celular, shërbime bankingu on-line, shërbim të kualifikuar të bankingut ndërkombëtar dhe produkte të ndryshme thesari. Gjithashtu, ajo investon në letra me vlerë dhe merr pjesë aktivisht në tregun ndërbankar lokal dhe ndërkombëtar.

BKT është krijuar në formën aktuale ligjore më 30 dhjetor 1992, megjithëse dega e saj e parë është hapur më 30 nëntor 1925.

BKT është subjekt i Ligjit nr. 8269 "Mbi Bankën e Shqipërisë" me datë dhjetor 1997 dhe i Ligjit nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", të datës 18 dhjetor 2006.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 25 Mars 2014, Banka krijoi rezervën ligjore prej 747,430 mijë Lek (ekuivalente e 7,355,870 USD). Pjesa e mbetur e fitimit neto për vitin 2013 u mbajt si fitim i pashpërndarë.

Në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 17 Tetor 2014, Banka rriti kapitalin e saj të paguar me shumën 2,986,077 mijë Lek (ekuivalente e 27,437,995 USD), duke përdorur rezervën ligjore prej 747,430 mijë Lek (ekuivalente e 6,867,867.11 USD) si edhe një pjesë të fitimit të saj të pashpërndarë prej 2,238,647 mijë Lek (ekuivalente e 20,570,127.89 USD). Rritja e kapitalit u konvertua në USD me kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për datën 17 Tetor 2014 (108.83 Lek për USD).

Në vijim të kësaj rritje, struktura aksionare mbeti e njëjtë, me vlerë nominale të aksioneve 12.35 USD, ndërsa numri i aksioneve u rrit me 2,221,700 aksione. Struktura aksionare më datë 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2014			***31 dhjetor 2013***		
	Nr. i aksioneve	**Totali USD**	**%**	**Nr. i aksioneve**	**Totali USD**	**%**
Calik Finansal Hizmetler A.S.	13,474,000	166,403,900	100	11,252,300	138,965,905	100

Drejtoria e Përgjithshme e BKT ndodhet në Tiranë. Aktualisht në Shqipëri, Banka zotëron një rrjet prej 61 degësh dhe 2 agjencish doganore. Njëzet e pese prej degëve ndodhen në Tiranë dhe të tjerat në Durres, Elbasan, Vlora, Shkodra, Fier, Pogradec, Korca, Bilisht, Gjirokastra, Delvina, Saranda, Orikum, Berat, Kucova, Lushnja, Librazhd, Peqin, Rrogozhina, Shkozet, Kavaja, Vora, Kamza, Fushe Kruja, Lac, Lezha, Rreshen, Kukes, Peshkopi, Bushat dhe Koplik, të ndjekura nga agjencitë doganore në Portin e Durrësit dhe Aeroportin e Rinasit. Gjatë vitit 2014, Banka hapi tre degë të reja në Tiranë.

Rrjeti në Kosovë përfshin 25 njësi. Gjashtë njësi ndodhen në Prishtinë, ndërsa të tjerat janë të vendosura në Prizren, Peja, Gjilan, Ferizaj, Mitrovica, Gjakova, Vushtrri, Fushe Kosova, Podujeva, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Hani i Elezit, Dheu i Bardhe, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj.

Banka kishte 1,287 punonjës (2013: 1,161) në datën 31 dhjetor 2013, nga të cilët 337 (2013: 274) i përkasin Degës së Kosovës.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ('SNRF').

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur bazuar në kosto historike, përveç instrumenteve financiare të gatshme për shitje, të cilët janë matur me vlerën e drejtë, investimeve në pronë, të cilat janë matur me vlerën e drejtë dhe aktiveve afatgjata të mbajtura për shitje, të cilat janë matur me vlerën më të ulët mes vlerës së mbetur dhe vlerës së drejtë, duke i zbritur kostot e shitjes.

Për qëllime të raportimit financiar, përllogaritjet e vlerës së drejtë janë grupuar në Nivelet 1, 2 ose 3, bazuar në nivelin e verifikueshmërisë të elementëve të llogaritjes së vlerës së drejtë dhe në rëndësinë e këtyre elementëve në llogaritjen e vlerës së drejtë në tërësi, siç pershkruhet më poshtë:

- Informacionet e përdorura për përllogaritje në Nivelin 1 janë çmimet e tregut të listuara (të pa rregulluara), në një treg aktiv për aktive ose detyrime të njëjta, në të cilat entiteti ka akses në datën e llogaritjes së vlerës së drejtë;
- Informacionet e përdorura për përllogaritje në Nivelin 2 janë të dhëna të ndryshme nga çmimet e listuara në treg të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme për aktivin ose detyrimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte; dhe
- Informacionet e përdorura për përllogaritje në Nivelin 3 janë të dhëna jo të verifikueshme për aktivin ose detyrimin.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në USD. Monedha funksionale e Bankës është Lek.

Banka ka zgjedhur t'i prezantojë pasqyrat financiare në USD, meqënese kapitali i saj është i zotëruar plotësisht nga investitorë ndërkombëtarë, të cilët kanë kontribuar kapitalin fillestar në USD dhe e vëzhgojnë përformancën e investimit në USD.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen si dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementët e rëndësishëm të pasigurive të vlerësimit dhe mbi gjykimet kritike në përdorimin e politikave kontabël me efekt të rëndësishëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara, jepet në shënimet 4 dhe 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara dhe në mënyrë të njëjtë nga njësitë e Bankës.

(a) Baza e konsolidimit

(i) Filialet

Filialet janë njësi (degë) të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka ka fuqi mbi një njësi ekonomike, është e ekspozuar, ose ka të drejta mbi përfitimet e ndryshueshme nga përfshirja e saj tek njësia, dhe ka aftësinë për të përdorur fuqinë e saj për të ndikuar në përfitimet e njësisë. Banka rivlerëson nëse ka apo jo kontroll mbi një filial, nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime të një ose më shumë nga tre elemente të kontrollit të listuara më lart.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Baza e konsolidimit (vazhdim)

(i) Filialet (vazhdim)

Konsolidimi i një filiali fillon nga momenti kur Banka merr kontrollin mbi filialin dhe ndalon kur Banka humb kontrollin e filialit. Të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali, të blerë apo shitur gjatë vitit njihen në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse nga data kur Banka mer kontrollin deri në datën kur Banka humbet kontrollin mbi njësinë.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur politika kontabël të njëjta për transaksione të njëjta dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.

Në datën 3 shtator 2007, BKT hapi degën e saj të parë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyra Administrative e kësaj dege u hap në qytetin e Prishtinës, Kosovë. Monedha funksionale e degës është EURO. Efekti i kthimit të veprimeve në monedhë të huaj në monedhën funksionale të Bankës shpjegohet në Shënimin 3.(b).(ii) më poshtë.

(ii) Veprimet e eliminuara gjatë konsolidimit

Gjendjet e aktiveve dhe detyrimeve brenda grupit, dhe të ardhurat dhe shpenzimet që vijnë nga veprimet brenda grupit (me përjashtim të fitimeve ose humbjeve nga veprimet në monedhë të huaj), janë eliminuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e parealizuara janë eliminuar në të njëjtën mënyrë si fitimet e parealizuara, por deri në masën që nuk ka evidencë për rënie të vlerës.

(b) Monedha të huaja

(i) Veprimet në monedhë të huaja

Veprimet në monedhë të huaj janë kthyer në monedhën funksionale respektive me kursin e këmbimit të datës kur është kryer veprimi. Aktivet dhe pasivet monetare, të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit i instrumenteve monetare, është ndryshimi midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të periudhës, e regulluar kjo për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale, me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, që maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Ndryshimet që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit të valutave janë njohur në të ardhura ose shpenzime

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat shprehen me kosto historike, këmbehen me kursin e datës së veprimit, me përjashtim të kapitalit aksionar të paguar, i cili është emetuar dhe mbahet në USD sipas legjislacionit në Shqipëri, dhe në veçanti në përputhje me Ligjin nr. 8634, datë 6 korrik 2000, sipas marrëveshjes ndërmjet aksionerëve të Bankës dhe Republikës së Shqipërisë mbi privatizimin e Bankës.

Për më tepër, Rregullorja e Operacioneve të Bankës kërkon që kapitali aksionar i paguar të mbrohet nga aktivet në USD, dhe prandaj është i trajtuar si një zë monetar, me diferencën e rivlerësimit të kaluar në fitim/humbje së bashku me diferencën e rivlerësimit të aktivit korrespondues në USD, të cilat kompensojnë njëra-tjetrën në një mënyrë të natyrshme.

(ii) Operacionet e huaja

Aktivet dhe detyrimet janë të kthyera në Lek me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të ardhurat dhe shpenzimet janë kthyer në Lek me kursin e datës së veprimit. Diferencat e kursit të këmbimit që lidhen me konvertimin e operacioneve të huaja, janë njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse. Këto diferenca janë njohur në rezervën e rivlerësimit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Monedha të Huaja (vazhdim)

(iii) Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit

Përkthimi i pasqyrave financiare nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit është si më poshtë:

- aktivet dhe detyrimet në datën e raportimit (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit, i cili është kursi i Bankës së Shqipërisë 1 USD = 115.23 Lek (2013: 101.86).
- të ardhurat dhe shpenzimet (duke përfshirë shifrat krahasuese) janë kthyer me kurset e datës së veprimeve.
- zërat e kapitalit, përveç fitimit neto, kapitalit të paguar dhe të ardhurave te tjera përmbledhëse janë kthyer me kursin e mbylljes në datën e raportimit.
- kapitali aksionar i paguar është kthyer siç është përshkruar në paragrafin 3(b), (i) më sipër; dhe
- të gjitha diferencat prej kursit të këmbimit janë njohur si një përbërës i veçantë i kapitalit në llogarinë e 'Rezervës së konvertimit'.

(iv) Veprimet e shkëmbimit të monedhave të huaja "spot"

Banka, gjatë veprimtarisë normale të biznesit ndërmerr veprime për shkëmbimin e monedhave të huaja ("spot"), për të cilat data e kryerjes është 1 ose 2 ditë pas datës së tregtimit. Këto veprime janë regjistruar në pasqyrat financiare në datën e kryerjes. Diferencat në monedhë të huaj njihen në fitim/humbje në datën e shlyerjes.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton saktësisht pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së parashikuar të aktivit ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër, kur duhet) deri në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Kur llogarit normën e interesit efektiv, Banka vlerëson flukset e ardhshme monetare duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet dhe shumat e paguara apo të arkëtuara, që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e veprimeve përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

(d) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Të ardhurat e tjera nga komisionet dhe tarifat njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa veprimesh ose shërbimesh, të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë operative janë njohur në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë. Zbritjet që ofrohen si nxitje për nënshkrimin e kontratave të qirave, njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë përgjatë jetës së qirasë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e mëposhtme: njohjen fillestare të emrit të mirë, njohjen fillestare të aktiveve apo detyrimeve në një veprim që nuk është kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as fitim/humbjen kontabël dhe as atë të tatueshëm, dhe diferenca lidhur me investimet në filiale në masën që ato mund të mos i kthejnë këto në të ardhmen. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Në llogaritjen e tatimit aktual dhe të shtyrë Banka merr në konsideratë ndikimin e disa pozicioneve të pasigurta, nëse duhet të llogarisë taksa dhe interesa shtesë. Banka beson që përllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për të gjitha vitet tatimore të hapura bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë këtu interpretimet e ligjeve tatimore dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në çmuarjen dhe supozimet dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të ardhshme. Informacione të reja që mund të bëhen të disponueshme mund të shkaktojnë që Banka të ndryshojë gjykimin e saj mbi përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor të periudhës së kryerjes së këtyre përcaktimeve.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që do të realizohet fitim i ardhshëm i tatueshëm, në mënyrë që të mund të përdoret kundrejt tij. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal. Të ardhura të tjera të tatueshme nga shpërndarja e dividendëve, njihen në të njëjtën kohë kur njihet edhe detyrimi për të paguar dividendin.

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huatë, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuar dhe detyrimet e varura në datën kur ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit, në të cilën Banka zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivet e detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivet dhe detyrimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë. Kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare (përvec aktiveve dhe detyrimeve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes) shtohen ose zbriten nga vlera e drejtë e aktiveve ose detyrimeve financiare, sipas rastit, në njohjen fillestare. Kostot e transaksionit të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes njihen menjëherë në fitim ose humbje.

(ii) Klasifikimi

Aktivet financiare klasifikohen në kategori të specifikuara, si vijon: Aktive financiare 'me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ‘ investimet të mbajtura deri në maturim, aktive financiare për shitje, hua dhe të arkëtueshme’. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare njihen dhe çregjistrohen në datën e tregtimit. Blerje ose shitje të rregullta janë ato blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë transferimin e aktiveve brenda afatit kohor të caktuar të vendosura nga rregullore ose marrëveshje në treg.

Referoju gjithashtu politikave kontabël 3(h), (i) dhe (j).

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivin financiar, dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit te një palë tjetër. Në qoftë se Banka nuk transferon ose nuk mban kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë aktivin e transferuar Banka vazhdon të njohë interesin e mbartur mbi aktivin dhe pasivin që e shoqëron për shumat që mund të duhet të paguajë. Nëse Banka mbart kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktivi financiar të transferuar, Banka vazhdon të njohë aktivin financiar dhe gjithashtu njeh një hua të mbuluar me kolateral për shumën e parave të marra. Banka çregjistron detyrimet financiare vetëm, dhe vetëm kur detyrimet e Bankës janë shkarkuar, anuluar ose kanë skaduar. Diferenca midis vlerës kontabël të pasivit financiar të panjohur, dhe shumës së paguar dhe të pagueshmeve njihet në fitim ose humbje.

Banka merr pjesë në veprime, me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen të gjitha rreziqet dhe përfitimet apo pjesa më e madhe e tyre, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull huadhënien e letrave me vlerë dhe veprimet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi konvergjuese ne kembim te aktiveve, veprimi konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar, i ngjashëm me veprimet e riblerjes.

Banka çregjistron aktivin kur ajo nuk ka kontroll mbi të, në veprimevet ku Banka as nuk ruan dhe as nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Të drejtat dhe detyrimet që mbahen pas transferimit njihen veçant si aktiv apo detyrim, sipas rastit. Në transferta ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së saj në vazhdimësi, që përcaktohet nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivit të transferuar.

Në disa veprime Banka ka detyrimin për ti shërbyer aktivit financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar përfundon së njohuri tërësisht kur plotësohen kriteret e çregjistrimit. Një aktiv apo detyrim përfundon së njohuri për kontratën e shërbimit, varur nga fakti nëse tarifa e shërbimit është më e përshtatshme (aktiv) ose është më pak e përshtatshme (detyrim) për kryerjen e shërbimeve.

Banka bën fshirjen e kredive dhe investimeve kur përcaktohet se ato janë të paarkëtueshme.

(iv) Netimi

Aktivet financiare netohen me detyrimet financiare dhe vlera e tyre neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje të lindura nga një grup veprimesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Bankës.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e këstit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja e vlerës së tregut

Vlera e tregut është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet, ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirëinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes.

Banka e llogarit vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të kuotuara në një treg aktiv për atë instrument, në rast se këto janë të disponueshme. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuara janë rregullisht të gatshme dhe paraqesin veprimet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Në qoftë se nuk ka treg aktiv për një instrument financiar, Banka vendos vlerën e tregut duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e veprimeve më të fundit të kryera midis palëve të vullnetshme, të mirë informuara (nëse ka të tilla), krahasime me vlerën e drejtë për instrumente të tjerë të ngjashëm, analizat e fluksit monetar të skontuar, modelet e vendosjes së çmimit për opsionet. Teknika e vlerësimit e zgjedhur përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në inputet specifike të Bankës. Ajo përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në caktimin e çmimit dhe është në përputhje me metodologjitë e pranuara ekonomike për vlerësimin e instrumenteve financiarë. Inputet për teknikat e vlerësimit pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë e tregut dhe matjet e faktorëve të rrezikut të kthimit, të qenësishëm në instrumentin financiar. Banka rishikon teknikën e vlerësimit dhe e teston atë për vlefshmëri, duke përdorur çmime nga veprime aktuale të mbikëqyrura lidhur me të njëjtin instrument, ose bazuar në të dhënat e disponueshme e të mbikëqyrura në treg.

Kur një aktiv është blerë ose një pasiv është krijuar në një transaksion këmbimi për atë aktiv ose pasiv, çmimi i transaksionit është çmimi i paguar për të blerë aktivin ose i marrë për të krijuar pasivin (një çmim hyrje). Në të kundërt, vlera e drejtë e aktivit ose detyrimit është çmimi që do të marrë për të shitur aktivin ose paguar për transferimin e detyrimit (një çmim dalje). Në shumë raste çmimi i transaksionit është i barabartë me vlerën e drejtë (që mund të jetë rasti kur në datën e transaksionit, transaksioni për të blerë një aktiv zhvillohet në tregun në të cilin pasuria do të shitet). Në përcaktimin nëse vlera e drejtë në njohjen fillestare është e barabartë me çmimin e transaksionit, Banka merr në konsideratë faktorë të veçantë të lidhur me transaksionin, aktivin ose pasivin.

Kur çmimi i transaksioneve paraqet evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me çmimin e transaksionit dhe çdo diferencë midis këtij çmimi dhe vlerës fillestare të marrë nga një model vlerësimi, është njohur më pas në fitim ose humbje në varësi të fakteve individuale dhe rrethanave të transaksionit , por jo më vonë momentit kur vlerësimi është mbështetur plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është mbyllur.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidenca objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Treguesit objektivë që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijnë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një huaje me kushte dhe afate të cilat Banka nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një investim, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me paaftësi për të paguar Bankën. Për më tepër, rënia e konsiderueshme apo e shtrirë në kohë e vlerës së tregut kundrejt kostos së investimeve për letrat me vlerë te kapitalit është një tregues objektiv zhvlerësimi.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Banka konsideron treguesit e zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet dhe investime të mbajtura deri në maturim si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Të gjitha huatë e paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen për zhvlerësim specifik. Për të gjitha huatë e paradhëniet dhe investimet e mbajtura deri në maturim të cilat janë individualisht të rëndësishme, të cilat nuk janë për t'u zhvlerësuar specifikisht, kryhet një rishikim për zhvlerësim në grup, që ka ndodhur, por nuk është identifikuar ende.

Të gjitha huatë dhe investimet e mbajtura deri në maturim, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim duke grupuar së bashku huatë e financimet dhe investimet e mbajtura deri në maturim që kanë karakteristika të ngjashme rreziku.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari provizioni përkundrejt huave. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet rënies së vlerës së zhvlerësimit si pasojë e zvogëlimit të periudhës së skontimit. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton pakësim të zhvlerësimit, zvogëlimi i zhvlerësimit rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Humbja nga zhvlerësimi i letrave me vlerë të mbajtura për shitje njihet duke transferuar humbjen kumulative, e cila është njohur direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse të fitim/humbjes. Humbja kumulative që është riklasifikuar nga të ardhura të tjera përmbledhëse në fitim/humbje është diferenca ndërmjet kostos së blerjes, së cilës i zbriten ripagimet e principalit dhe amortizimi, dhe vlerës së tregut aktuale së cilës i zbritet zhvlerësimi që është njohur më parë në fitim/humbje. Ndryshimet që i përkasin vlerës në kohë të parasë, janë reflektuar si një komponent i të ardhurave nga interesi. Nëse, në një periudhë të ardhme, vlera e tregut e një letre me vlerë të vlefshme për shitje të zhvlerësuar më parë rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes në fitim/humbje të humbjes nga zhvlerësimi, kjo humbje nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht me shumën e kthimit të njohur në fitim ose humbje.

(h) Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në bankat qendrore dhe të tjera aktive financiare shume likuide, me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat nuk janë subjekt i një rreziku domethënës ndaj ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe që përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

(i) Derivativët e mbajtur për menaxhimin e riskut

Derivativët e mbajtur për menaxhimin e riskut përfshijnë të gjithë aktivet dhe detyrimet derivative, të cilat nuk klasifikohen në aktivet apo detyrimet e tregtueshme. Derivativët e mbajtur për qëllime të administrimit të riskut mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tregut.

(j) Huatë

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëhere apo në periudhën afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (apo aktiv shumë të ngjashëm me të) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme ("marrëveshje të anasjella të riblerjes"), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç rastit kur Banka zgjedh të mbajë huatë dhe paradhëniet me vlerën e tregut nëpërmjet fitim/humbjes siç përshkruhet në politikat kontabël 3(g),(vi).

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Investime

Investimet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, dhe në rastin e investimeve jo me vlerë te drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, plus kostot shtesë të veprimit direkt, dhe më pas regjistrohen në varësi të klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, ose të vlefshme për shitje.

(i) Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat Banka ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje.

Investimet që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo rast shitje ose riklasifikimi përpara maturimit, të një sasie më shumë se sa të rëndësishme të investimeve që mbahen deri në maturim, do të sillte riklasifikimin e të gjithë investimeve që mbahen deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe kjo do ta pengonte Bankën të klasifikonte investimet si të mbajtura deri në maturim, gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiarë pasues.

(ii) Investime të vlefshme për shitje

Investime e mbajtura për tregtim janë instrumente jo-derivative të cilat janë klasifikuar si të mbajtura për shitje ose nuk janë klasifikuar si ndonjë kategori tjetër e aktiveve financiare. Investimet e mbajtura për tregtim mbahen me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim/humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për investime në letra me vlerë të mbajtura për shitje njihet në fitim/humbje.
Ndryshime të tjera në vlerën e tregut njihen direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse deri në momentin kur investimi shitet ose zhvlerësohet, moment kur humbjet ose fitimet kumulative të njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse, njihen në fitim ose humbje.

(iii) Investime të mbajtura për tregtim

Një aktiv financiar klasifikohet si investim i mbajtur për tregtim nëse:

- është blerë kryesisht për qëllim shitje në një periudhë të afërt; ose
- në njohjen fillestare është pjesë e një portofoli të identifikuar instrumentash financiare që Banka administron në tërësi dhe ka një model të fundit aktual për marrjen e një fitimi në një periudhë afatshkurtër; ose
- është një derivat që nuk është paracaktuar si një instrument mbrojtës.

Këto aktive financiare mbahen me vlerën e tregut, me çdo fitim ose humbje që lind nga rivlerësimi të njohur në fitimin ose humbjen e periudhës. Fitimi ose humbja neto e njohur në fitimin ose humbjen e periudhës mbart çdo dividend, apo interesa të fituara nga aktivi financiar.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(l) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentët kryesorë) të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese a të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të elementit, nëse është e mundshme që Banka në të ardhmen të ketë përfitime ekonomike, që i atribuohen atij elementi, dhe nëse kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvleresimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo zëri të aktiveve afatgjata të trupëzuara. Toka nuk zhvlerësohet.
Vlerësimi për jetën e dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

- Ndërtesa dhe përmirësime të ambjenteve me qera 20 vjet
- Mjete transporti dhe pajisje të tjera 5 vjet
- Pajisje zyre 5 vjet
- Kompjutera dhe pajisje elektronike 4 vjet

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(m) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Zërat e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara përfshijnë programet kompjuterike të blera nga Banka. Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluara nga rënia në vlerë.

Shpenzimet për zhvillimin e programeve kompjuterike nga vetë Banka njihen si aktive kur Banka është në gjendje të tregojë qëllimin dhe aftësinë për të plotësuar zhvillimin dhe përdorur programet kompjuterike në një mënyrë që do të gjenerojë përfitime ekonomike të ardhme, dhe mundet të masë me besueshmëri kostot e përfundimit të zhvillimit. Kapitalizimi i kostove të programeve të zhvilluara nga vetë Banka përfshin të gjithë kostot që i atribuohen direkt zhvillimit të programit kompjuterik dhe amortizohen me jetën e dobishme të tyre. Zhvillimi nga vetë Banka i programeve kompjuterike shprehet me koston e kapitalizuar duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe rënie në vlerë.

Shpenzime vijuese për programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime ndikojnë në rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik të aktivit të cilit i ngarkohen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të programit kompjuterik duke filluar nga data në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme e programeve kompjuterike është vlerësuar në katër vjet.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(n) Aktivet e përfituara nga proçesi ligjor

Aktivet e përfituara nga proçesi ligjor, janë përftuar përmes ekzekutimit të garancisë mbi të arkëtueshmet financiare dhe kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si aktiv afatgjatë i mbajtur për shitje, apo si aktive afatgjata të investimit.

(i) Aktive afatgjata që mbahen për t'u shitur

Aktivet afatgjata të mbajtura për t'u shitur pritet të rikuperohen kryesisht nëpërmjet shitjes dhe jo kundrejt përdorimit të vazhdueshëm. Menjëherë para klasifikimit si të mbajtura për t'u shitur, aktivet rimaten sipas politikave kontabël të Bankës. Prej atij momenti, aktivet maten me më të voglën mes vlerës kontabël dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Humbjet nga zhvlerësimi në klasifikimin fillestar dhe humbjet apo fitimi nga rimatja në vijimësi, njihen në fitim/humbje. Fitimet njihen deri në masën që nuk tejkalojnë ndonjë humbje kumulative nga rënia në vlerë.

(ii) Aktivet afatgjata të investimit

Një aktiv afatgjatë i investimit është aktiv afatgjatë i mbajtur për të përfituar të ardhura nga qiraja, ose për fitime kapitale, ose për të dyja, por jo për përdorim në aktivitet ose furnizimin e të mirave apo shërbimeve, apo për qëllime administrative. Aktivet afatgjata të investimit të mbajtura për fitime kapitale maten me vlerën e drejtë referuar çmimeve të tregut, me çdo ndryshim të vlerës së tyre, të njohur në fitim ose humbje. Aktivet afatgjata të investimit të dhëna me qera palëve të treta paraqiten me kosto, minus zhvlerësimin. Kur përdorimi i një aktivi afatgjatë ndryshon, aq sa ai riklasifikohet si prona dhe pajisje, vlera e drejtë e aktivit në datën e riklasifikimit bëhet kostoja e tij për kontabilizimin e mëtejshëm.

(o) Rënia e vlerës e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka tregues për rënie vlere. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të matura për njësi gjeneruese të mjeteve monetare, fillimisht zvogëlojnë vlerën kontabël të ndonjë aktivi jo-material që është pjesë e njësisë dhe pastaj redukton vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (apo grup njësish) me një shpërndarje proporcionale mes tyre.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të vlerësuarara të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për evidencë nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më.

Një humbje për zhvlerësim anullohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anullohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin ose amortizimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia e vlerës.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(p) Investime në pjesëmarrje

Një pjesëmarrje është një investim në një entitet mbi të cilin Banka ka një ndikim të rëndësishëm. Ndikim i rëndësishëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet mbi politikat operacionale dhe financiare të filialit, por nuk është një kontroll i plotë ose një kontroll i përbashkët i këtyre politikave.

Rezultatet dhe pozicionet financiare të pjesëmarrjeve janë përfshirë në këto pasqyra financiare të konsoliduara duke përdorur metodën e kapitalit në kontabilizim, përvec kur investimi eshte klasifikuar si i mbajtur për shitje, rast në të cilin është kontabilizuar në përputhje me SNRF 5. Në përputhje me SNK 28 'Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta' sipas metodës së kontabilizimit të kapitalit, një investim në një pjesëmarrje njihet fillimisht në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me kosto dhe rregullohet më pas për të njohur pjesën e Bankës në fitimin ose humbjen dhe të ardhurat e tjera përmbledhëse të pjesëmarrjes. Kur pjesa e humbjeve të Bankës në një pjesëmarrje tejkalon interesin e Bankës në atë pjesëmarrje (i cili përfshin ndonjë interes afatgjatë që, në thelb, janë pjesë e investimit neto të Bankës në pjesëmarrje), Banka ndërpret njohjen e aksioneve të saj, duke pranuar pjesën e saj të humbjeve të mëtejshme. Humbjet shtesë njihen vetëm në masën që Banka ka detyrime ligjore ose konstruktive apo ka kryer pagesa të bëra në emrin e pjesëmarrjes.

Kërkesat e SNK 39 zbatohen për të përcaktuar nëse është e nevojshme për të njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi në lidhje me investimet e Bankës në një pjesëmarrje. Kur është e nevojshme, e gjithë vlera kontabël e investimit testohet për zhvlerësim në përputhje me SNK 36 Zhvlerësimi i Aktiveve si një aktiv të vetëm duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme (vlerën më të lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes) me vlerën e tij kontabël. Çdo humbje e njohur nga zhvlerësimi është pjesë e vlerës kontabël të investimit. Çdo rimarrje e kësaj humbjeje nga zhvlerësimi njihet në përputhje me SNK 36 deri në masën që shuma e rikuperueshme e investimit më pas të rritet.

Me shitjen apo nxjerrjen jashtë përdorimit të një pjesëmarrje e cila rezulton në humbjen e ndikimit të rëndësishëm nga ana e Bankës në atë pjesëmarrje, çdo investim i mbajtur matet me vlerën e drejtë në atë datë dhe si vlerë e drejtë konsiderohet vlera e drejtë në njohjen fillestare si një aktiv financiar në përputhje me SNK 39. Diferenca midis vlerës kontabël të mëparshme të pjesëmarrjes që i takon interesit të mbartur dhe vlerës së drejtë, përfshihet në përcaktimin e fitimit ose humbjes nga nxjerrja jashtë përdorimit e pjesëmarrjes. Gjithashtu, të gjitha shumat e njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse në lidhje me këtë pjesëmarrje, Banka i konsideron në të njëjtën mënyrë siç do të kërkohej nëse pjesëmarrja do të kishte nxjerrë jashtë përdorimit në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivet ose detyrimet e lidhura me të. Si pasojë, në qoftë se një fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse nga ajo pjesëmarrje do të riklasifikohet në fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve ose detyrimeve të lidhura me të, Banka riklasifikon fitimin ose humbjen nga kapitali në fitim ose humbje (si rregullim riklasifikimi) kur ajo humbet ndikimin e rëndësishëm mbi atë pjesëmarrje.

(q) Depozitat dhe huatë (përfshirë detyrimet e vonuara)

Depozitat dhe huatë (përfshirë detyrimet e vonuara) janë pjesë e burimeve të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen ("repo" ose "huadhenie aksioni"), marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Depozitat dhe huatë (përfshirë edhe detyrimet e vonuara) maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të veprimit, dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(r) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv të tanishëm i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka mundësi që për të shlyer detyrimin, të kërkohet një dalje e të mirave ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

Një provizion për ristrukturimin njihet kur Banka ka aprovuar një plan ristrukturimi të detajuar dhe formal dhe ristrukturimi ka filluar apo është publikuar. Kostot e ardhme operative nuk provizionohen.

Një provizion për kontratat pa fitim njihet kur përfitimet e pritshme për t'u marrë nga Banka për këto kontrata, janë më të vogla se kostot e pashmangshme për të plotësuar detyrimin sipas kontratës. Provizioni matet me vlerën aktuale të më të voglës mes kostos së pritshme të përfundimit të kontratës dhe kostos neto të pritshme për të vazhduar me kontratën. Para se një provizion të krijohet, Banka njeh çdo humbje zhvlerësimi të aktiveve që lidhen me atë kontratë.

(s) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që mbulojnë përfitimet e punonjësve pasi dalin në pension. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për dhënien e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

(ii) Plani i përfitimit të pensionit

Banka ka krijuar një fond plan pensioni, plotësisht të financuar nga punëdhënësi i quajtur Programi i Mbështetjes së Stafit (shiko shënimin 22 "Fondi rezervë për punonjësit që dalin në pension") në vitin 2002. Shuma që regjistrohej tek ky fond ("PMS") vendosej në fillim të vitit në masën 5% të shpenzimeve vjetore të planifikuara për pagat e personelit.

Sipas planit të mësipërm, shumës së përllogaritur për punonjësit i shtohej interesi, i cili llogaritej që nga data kur punonjësit do të largoheshin dhe deri në daljen e tyre në pension. Kjo shumë do t'i paguhet punonjësve, vetëm kur ata të mbërrijnë moshën e pensionit, përcaktuar sipas ligjit shqiptar, në këste mujore të barabarta me minimumin e 75% e pensionit mujor shtetëror derisa fondi i akumuluar për punonjësit të konsumohet.
Bazuar në rezolutën e Këshillit Drejtues, në fuqi që nga 30 shtatori 2010, Banka ka ndaluar së investuari në këtë fond ("PMS"), duke e transformuar atë në Programin e Kredisë për Mbajtjen e Stafit ('PKMS'). Ndryshimet demografike në forcën punëmarrëse gjatë dhjetë viteve të fundit dhe mosha mesatare 31 vjeç e punonjësve, ku 80% e punonjësve janë nën moshën 40 vjeç, ka rezultuar se PMS nuk është tërheqëse për pjesën më të madhe të punonjësve të Bankës, pasi mund të gëzohet vetëm me daljen në pension. Në dallim nga ky plan, PKMS do të jetë më i dobishëm për të gjithë punonjësit e Bankës, sepse do të ofrojë kredi për shtëpi apo kredi konsumatore me terma preferencialë. Shuma e llogaritur për personat përfitues nga Programi i Mbështetjes së Stafit është ngrirë në të njëjtën datë. Shuma e ngrirë si pasojë e tranformimit të programit të "PMS" në "PKMS" më 30 shtator 2010 dhe pjesa korresponduese e interesit vjetor, që do fitohet në të ardhmen deri në moshën e pensionit, matet në bazë të normës së obligacioneve qeveritare AAA, dhe regjistrohet si detyrim nga Banka.

(iii) Përfitimet afat-shkurtra

Detyrimet e përfitimeve afat-shkurtër të punonjësve maten në baza të paskontuara dhe janë shpenzuar sipas kryerjes së shërbimit lidhur me to.

Për shumën që pritet të paguhet sipas përfitimit monetar afat-shkurtër ose planeve të ndarjes së fitimeve, nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv të paguajë këtë shumë si rezultat i shërbimeve të kaluara të kryera nga punonjësit dhe detyrimet mund të maten në mënyrë të besueshme, njihet provizion.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(t) Raportimi i segmenteve

Një segment operues është një komponent i Bankës që është i përfshirë në aktivitete biznesi, nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe të kryejë shpenzime, duke përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me veprimet me komponentë të tjerë të Bankës, dhe rezultatet operative të të cilit, rishikohen në mënyrë të rregullt nga menaxhimi për të marrë vendime rreth ndarjes së burimeve të secilit segment dhe për të vlerësuar performancën e tyre, dhe për të cilin duhet informacion i veçantë i vlefshëm (shih shënimin 6). Forma e përdorur prej Bankës për raportim të segmentuar është bazuar në segmentimin gjeografik.

(u) Standarde dhe Interpretime në fuqi për periudhën raportuese

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"** – Subjektet e investimeve (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

- **Ndryshime në SNK 32 "Instrumentat financiare: Paraqitja"–** Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

- **Ndryshime në SNK 36 "Zhvlerësimi i aktiveve"–** Paraqitja e shumave të rikuperueshme për aktive jo financiare (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

- **Ndryshime në SNK 39 "Instrumentat financiar: Njohja dhe matja"** – Risitë e derivativëve dhe vazhdimësia e kontabilitetit mbrojtës (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

- **KIRFN 21 "Taxat" (**efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014).

Këto ndryshime në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Bankës.

(v) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare standardet, përmirësimet në standarded ekzistuese dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi.

- **SNRF 9 "Instrumentat financiare"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2018), Standardi përdor një qasje të vetme për të përcaktuar nëse një aktiv financiar matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet mbi mënyrën se si një njësi ekonomike manaxhon instrumentat e saj financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhës së parasë të aktiveve financiare. Standardi i ri gjithashtu do të kërkojë të përdoret një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar shumë metoda të ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare paraqesin problemin e luhatshmërisë në fitim ose humbje që lind nga një emetues zgjedhur për të matur vete borxhin me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë matjen ekzistuese me kosto të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke kufizuar ndryshimin me atë që kërkohet për të trajtuar problemin e vet të kreditit. Me kërkesat e reja, një njësi ekonomike që zgjedh për të matur një pasiv me vlerën e drejtë do të paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë të tij për shkak të ndryshimeve në vet rrezikun e kredisë të njësisë ekonomike në seksionin e të ardhurave të tjera përmbledhëse të pasqyrës së të ardhurave, në vend të brenda në fitim ose humbje.

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(v) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

Ndryshimet nga nëntor 2013 sjellin në fuqi një rishikim të konsiderueshëm të kontabilitetit që do të lejojë njësitë ekonomike për të pasqyruar më mirë aktivitetet e tyre të menaxhimit të rrezikut në pasqyrat financiare. Kjo i lejon ndryshimet për të paraqitur të ashtuquajturën çështje 'të kreditit të vet' që është i përfshirë tashmë në SNRF 9 Instrumentat Financiarë që do të aplikohen në mënyrë të izoluar, pa nevojën për të ndryshuar ndonjë aspekt tjetër të kontabilitetit për instrumentet financiare,

- **SNRF 14 "Regullatori per llogaritere ne shtyrje"** (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **SNFR 15 "Te ardhura nga kontratat me klientët**" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2017),.
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNK 28 "Investime në pjesëmarrje dhe sipërmarrje te perbashkëta"-** Shitja apo kontributi i pasurive ndërmjet nje investitori dhe bashkëpunetor të tij ose sipërmarrje të përsbashkët (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara" dhe SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera" dhe SNK 28 "Investime ne pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta"** – Subjektet e investimeve: Përjashtim konsolidimi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta"-** Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacionet e perbashkëta (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" –** Iniciativat e zbulimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 38 "Aktive jo-materiale" -** Sqarim i metodave të pranueshme të zhvleresimit dhe amortizimit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 16 "Prona, Impiantet dhe Pajisjet" dhe SNK 41 "Agrobiznesi" –** Agrobiznes: Bimët bartësi (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 Janar 2016),
- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** – Skemat e përfitimeve të përcaktura: Përfitimet e punonjësit (efektiv për periudhat vjetore qëfillojnë më apo pas datës 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale" -** Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale (efektiv për periudhat vjetore qëfillojnë më apo pas datës 1 janar 2016),
- **Ndryshime në disa standarde "Përmirësime të SNRF-ve (2010-2012)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 korrik 2014),
- **Ndryshime në disa standarde "Përmirësime të SNRF-ve (2011-2013)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 1,SNRF 3, SNRF13, SNK 16, SNK 40) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),

3. Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(v) Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi (vazhdim)

Ndryshime në disa standarde "Përmirësime të SNRF-ve (2011-2013)" që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 5,SNRF 7, SNRF13, SNK 19, SNK 34) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas dates 1 janar 2016),
Banka ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarte, rishqyrtime, dhe interpretime përpara datës së tyre efektive. Përveç efektit të SNRF 9, që do të vlerësohet nga Banka gjatë vitit 2015, Drejtimi parashikon se aplikimi i standardeve të tjera nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të konsoliduara të Bankës në periudhën fillestare të zbatimit.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi diskuton me Komitetin e Auditimit mbi zhvillimin, zgjedhjen dhe shënimet shpjeguese të politikave dhe vlerësimeve kritike të Bankës, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shih shënimin 5).

Fonde për humbjet nga zhvlerësimi i kredive

Aktivet e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave kontabël të përshkruara në 3(g)(vii).

Banka rishikon portofolin e kredive për të përcaktuar zhvlerësimin në baza mujore. Në përcaktimin nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në fitim/humbje, Banka bën gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të konsiderueshme në flukset e vlerësuara monetare të ardhme nga portofoli i kredisë para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vëzhguara që tregojnë se kanë ndodhur ndryshime të padëshiruara në statusin e pagesave të kredive në një grup, ose kushte ekonomike kombëtare apo lokale që lidhen me mospagimin e aktiveve në grup. Drejtimi përdor gjykime bazuar në eksperienca te humbjes historike për aktivet me karakteristika të rrezikut të kredisë dhe evidenca të zhvlerësimeve të ngjashme me ato të portofolit kur skedulohen flukset e ardhme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve të ardhme të parasë janë rishikuar në mënyrë të rregullt për të reduktuar çdo diferencë ndërmjet humbjes së vlerësuar dhe humbjes aktuale.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Banka ndjek udhëzimet e SNK 39 në klasifikimin e aktiveve financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, si të mbajtura deri në maturitet. Klasifikimi kërkon gjykime të rëndësishme. Në bërjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson qëllimin dhe aftësinë e saj për të mbajtur investime të tilla deri në maturitet. Nëse Banka dështon të mbajë këto investime deri në maturitet, përveç rasteve të veçanta, për shembull shitja e një shume jo të konsiderueshme afër maturitetit, do të kërkohet që të klasifikohet e tërë kategoria, si e vlefshme për tu shitur. Investimet do të duhet të maten me vlerën e drejtë dhe jo me koston e amortizuar.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu të dukshëm kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhen në politikën kontabël 3(g)(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe që nuk kanë transparencë në çmim, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi bazuar në likuiditetin, përqendrimin, pasigurinë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik. Referoju gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiarë" më poshtë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Gjykimet kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Bankës përfshijnë:

Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së tregut është trajtuar në shënimin 3(g)(vi).

Banka e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuara në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në inpute të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur çmime të kuotuara në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuara për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë të vëzhgueshëm në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuara për instrumente të ngjashëm ku kërkohen rregullime apo gjykime të rëndësishme e të pavëzhgueshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktivë bazohen në çmime tregu të kuotuara apo kuotime te agjentëve. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiarë Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiarë më të thjeshtë dhe më të zakonshëm, si norma interesi dhe këmbime monedhash që përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet dhe inputet model të vëzhgueshme janë zakonisht të vlefshme në treg për instrumente kapitale dhe huaje të listuara në bursa, derivativë të tregtueshëm me këmbim, dhe derivativë të thjeshtë të tregtueshëm mbi banak si Swaps mbi normat e interesit. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe e inputeve model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe inputeve varion në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarjet specifike dhe kushtet e përgjithshme në tregjet financiare.

Për instrumente financiare më komplekse, Banka përdor modele vlerësimi të veçanta, të cilat janë zakonisht të zhvilluara bazuar ne modele të njohura vlerësimi. Disa ose të gjithë inputet e rëndësishme në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme në treg dhe janë rrjedhojë e çmimeve të tregut ose kurseve ose janë vlerësuar bazuar në gjykime. Modelet e vlerësimit që përmbajnë inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi dhe vlerësimi nga drejtuesit në përcaktimin e vlerës së drejtë. Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve kërkohet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit për t'u përdorur, përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme për skontim.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

Vlera e Drejtë

Tabela më poshtë paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të matura me vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese, sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë, në të cilën është kategorizuar matja e vlerës së drejtë:

31 dhjetor 2014	**Shënime**	**Vlera kontabël**			**Fair Value**	
			Niveli 1	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Depozita dhe llogari me bankat	8	139,345,055	-	139,345,055	-	139,345,055
Bono thesari	9	276,418,401	-	276,418,401	-	276,418,401
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	10	745,191,900	201,932,405	480,422,876	62,836,619	745,191,900
Investime të mbajtura deri në maturim	11	198,822,024	75,800,377	115,521,376	-	191,321,753
Hua për bankat	12	173,290,510	-	173,290,510	-	173,290,510
Hua për klientët, neto	13	920,268,253	-	920,268,253	-	920,268,253
Totali i aktiveve financiare		**2,453,336,143**	**277,732,782**	**2,105,266,471**	**62,836,619**	**2,445,835,872**
Detyrime ndaj klientëve	18	2,140,818,985	-	2,140,818,985	-	2,140,818,985
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	19	326,914,452	-	326,914,452	-	326,914,452
Borxhi i varur	23	18,287,260	-	18,287,260	-	18,287,260
Totali i detyrimeve financiare		**2,486,020,697**	**-**	**2,486,020,697**	**-**	**2,486,020,697**

31 dhjetor 2013	**Shënime**	**Vlera kontabël**	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Totali**
Depozita dhe llogari me bankat	8	201,279,874	-	201,279,874	-	201,279,874
Bono thesari	9	236,724,368	-	236,724,368	-	236,724,368
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	10	697,179,575	194,903,826	423,269,186	79,006,563	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	11	217,755,420	49,736,912	168,512,656	-	218,249,568
Hua për bankat	12	121,650,866	-	121,650,866	-	121,650,866
Hua për klientët	13	886,202,417	-	886,202,417	-	886,202,417
Totali i aktiveve financiare		**2,360,792,520**	**244,640,738**	**2,037,639,367**	**79,006,563**	**2,361,286,668**
Detyrime ndaj klientëve	18	2,154,265,396	-	2,154,265,396	-	2,154,265,396
Detyrime ndaj bankave e institucioneve financiare	19	278,355,823	-	278,355,823	-	278,355,823
Borxhi i varur	23	13,796,864	-	13,796,864	-	13,796,864
Totali i detyrimeve financiare		**2,446,418,083**	**-**	**2,446,418,083**	**-**	**2,446,418,083**

Vlera e tregut e kontratave të kursit të këmbimit i afrohet vlerës kontabël të tyre, siç paraqitet në shënimet 17 dhe 22. Gjatë vitit nuk ka patur lëvizje midis nivelit 1 dhe 2 në hierarkinë e vlerës së drejtë.

5. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje e përgjithshme

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziqet e tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proçeset e Bankës për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Një instrument financiar është çdo kontratë që jep mundësinë për të marrë mjete monetare ose aktive të tjera financiare nga një palë tjetër (aktiv financiar) ose detyrimin për të dhënë mjete monetare ose ndonjë aktiv tjetër financiar ndonjë pale tjetër (detyrim financiar).

Instrumentet financiare rezultojnë me rrezik për Bankën. Rreziqet kryesore me të cilët përballet Banka janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit dhe ai i tregut. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës së huaj, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera çmimi.

Struktura e administrimit të rrezikut

Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut në Bankë. Këshilli ka themeluar Komitetin e Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve (ALCO) dhe Komitetet e Rrezikut të Kredisë, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut në pjesët e tyre përkatëse. Të gjithë këta, i raportojnë në mënyrë të rregullt Këshillit Drejtues për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë vendosur me qëllimin për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Banka, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Banka, përmes trajnimeve dhe standardeve e procedurave të menaxhimit, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut të Bankës, dhe për rishikimin e përshtatshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rrezikun me të cilin përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës ndihmohet në këtë funksion edhe nga Auditimi i Brendshëm. Auditimi i Brendshëm bën rishikime si të rregullta ashtu edhe rishikime ad-hoc të kontrolleve për administrimin e rrezikut dhe procedurave, rezultate të cilat raportohen në Komitetin e Auditimit.

(b) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe bankave të tjera dhe nga investimet. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Banka konsideron të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut te kredisë (si rreziku i mospagimit të kredisë, rreziku i sektorit dhe vendit). Banka ka krijuar një Komitet Kredie për të mbikqyrur aprovimin e kërkesave të kredive. Kërkesat e kredive me shuma më të mëdha se 1,000,000 Euro aprovohen vetëm me vendimin e Këshillit Drejtues të Bankës. Ka një fokusim të vazhdueshëm për cilësinë e kredive në momentin e aprovimit dhe gjatë jetës së tyre.

Çdo njësi kërkohet të jetë në përputhje me politikat dhe procedurat e kredisë së Bankës. Auditime të rregullta të njësive të biznesit dhe Departamentit të Administrimit të Rrezikut të Kredisë ndërmerren nga Auditimi i brendshëm.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

Ekspozimi maksimal ndaj Rrezikut të kredisë para kolateralit dhe ndonjë rritjeje tjetër të kredisë më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet më poshtë:

	31 dhjetor 2014	**31 dhjetor 2013**
Bono thesari	276,418,401	236,724,368
Të arkëtueshme nga bankat e tjera	312,635,565	322,930,740
Hua për klientët, neto	920,268,253	886,202,417
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	745,191,900	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	198,822,024	217,755,420
Garanci financiare	63,203,153	115,317,133
Letra krediti në pritje	12,090,058	6,303,982
Angazhime për të dhënë kredi	124,572,829	69,075,578
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë	**2,653,202,183**	**2,551,489,213**

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo nuk do jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të principalit në bazë të kushteve të kontratës. Këto kredi cilësohen si A deri në D, sipas sistemit te brendshëm të Bankës për cilësimin e rrezikut të kredisë. Komiteti i Rrezikut të BKT është i angazhuar me cilësimin e klientëve dhe me kategorinë e tyre përkatëse. Ai vendos mbi ndryshimet në cilësim dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas proçedurave të monitorimit. Komiteti i Rrezikut cilëson çdo kredi sipas këtyre faktorëve:

- Aftësia për të paguar
- Kushtet financiare
- Aftësia e drejtimit
- Kolaterali dhe Garantuesit
- Struktura e kredive
- Industria dhe ekonomia

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Hua të vonuara por të pa-zhvlerësuara

Huatë dhe investimet e vonuara por të pa-zhvlerësuara janë ato për të cilat pagesat e interesit ose të principalit sipas kontratës, janë me vonesë por që Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të garancisë/kolateralit të vlefshëm dhe/ose shkallës së arkëtimit të shumës që i detyrohen Bankës.

Hua me kushte të ndryshuara

Hua me kushte të ndryshuara janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt.

Pasi huaja është ristrukturuar, ecuria e saj monitorohet në vazhdimësi për qëllime zhvlerësimi.

Fondi për zhvlerësim

Banka vendos një fond për humbjet nga rëniet ne vlere, i cili përfaqëson vlerësimin e humbjeve të ndodhura në portofolin e kredive. Kjo lidhet me komponentin e humbjes specifike për ekspozimet e rëndësishme individuale. Referojuni shënimit 4.

Politika e fshirjes nga librat

Banka fshin një hua ose investim (dhe ndonjë fond për humbjet nga zhvlerësimi prej tyre), me vendimin e Komitetit të Kredisë së Bankës, në përputhje me rregulloren e bankës së Shqipërisë "Mbi administrimin e rrezikut të kredisë". Vendimi i fshirjes merret pasi është marrë në konsideratë ndodhja e ndryshimeve në pozicionin financiar të huamarrësit, e tillë që çon në paaftësi të huamarrësit për të paguar detyrimin, ose hyrjet nga kolaterali nuk janë të mjaftueshme për të paguar ekspozimin e mbetur.

	Hua për klientët			
31 dhjetor 2014	**Individë**	**Korporata**	**Paradhënie**	**Totali**
Pa ditë-vonesa dhe zhvlerësim	195,822,774	510,637,365	929,310	707,389,449
Me ditë-vonesa dhe të testuara individualisht, por jo të zhvlerësuara	79,125,651	123,544,780	50,746	202,721,177
Të zhvlerësuara në mënyrë individuale	13,308,460	22,777,359	1,976,526	38,062,345
Totali i kredive, bruto (Shënimi 13)	**288,256,885**	**656,959,504**	**2,956,582**	**948,172,971**
Fondi i zhvlerësimit individual	(8,750,727)	(8,036,574)	(1,973,932)	(18,761,233)
Fondi i zhvlerësimit kolektiv	(2,771,823)	(6,361,861)	(9,801)	(9,143,485)
Total i kredive, minus zhvlerësimin	**276,734,335**	**642,561,069**	**972,849**	**920,268,253**

	Hua për klientët			
31 dhjetor 2013	**Individë**	**Korporata**	**Paradhënie**	**Totali**
Pa ditë-vonesa dhe zhvlerësim	211,744,057	409,285,716	1,144,557	622,174,330
Me ditë-vonesa dhe të testuara individualisht, por jo të zhvlerësuara	75,978,262	174,803,779	49,766	250,831,807
Të zhvlerësuara në mënyrë individuale	15,858,186	21,758,502	2,456,922	40,073,610
Totali i kredive, bruto (Shënimi 13)	**303,580,505**	**605,847,997**	**3,651,245**	**913,079,747**
Fondi i zhvlerësimit individual	(7,992,067)	(7,663,202)	(2,450,472)	(18,105,741)
Fondi i zhvlerësimit kolektiv	(2,902,201)	(5,857,445)	(11,943)	(8,771,589)
Total i kredive, minus zhvlerësimin	**292,686,237**	**592,327,350**	**1,188,830**	**886,202,417**

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

E paraqitur më poshtë është një analizë sipas cilësisë së kredisë për kreditë e korporatave:

Vlerësimi	**31 dhjetor 2014**	**31 dhjetor 2013**
A – Mirë	7,045,304	28,421,605
B – Pranueshëm	507,649,811	379,012,101
C – Nën monitorim	104,930,535	167,212,776
D – E papranueshme	33,849,908	26,326,381
(Shënimi 13)	**653,475,558**	**600,972,863**
Interesi i përllogaritur	5,487,891	6,530,079
Minus: të ardhurën e komisionit të shtyrë	(2,003,945)	(1,654,945)
Totali	**656,959,504**	**605,847,997**

Më poshtë paraqitet lista e huave për klientët, ku vlera e tyre kontabël është rinegociuar dhe mbahen nën kontroll:

	Hua për klientët			
	Individë	**Korporata**	**Paradhënie**	**Totali i kredive**
31 dhjetor 2014	4,207,392	63,741,384	82,517	68,031,293
31 dhjetor 2013	2,885,200	50,714,803	94,448	53,694,451

Më poshtë paraqitet analiza e kredive në vonesë si të zhvlerësuara ashtu edhe të pa-zhvlerësuara në mënyrë individuale:

	Hua për klientët			
31 dhjetor 2014	**Individë**	**Korporata**	**Paradhënie**	**Total i kredive**
Ditë-vonesa deri në 31 ditë	21,922,786	34,595,221	333,921	56,851,928
Ditë-vonesa 32-60 ditë	9,076,360	6,022,202	98,692	15,197,254
Ditë-vonesa 61-90 ditë	9,874,341	8,544,548	289,328	18,708,217
Ditë-vonesa 91-180 ditë	3,364,313	5,566,294	54,615	8,985,222
Ditë-vonesa 181 ditë - 365 ditë	5,608,049	13,250,257	-	18,858,306
Ditë-vonesa 1-2 vite	4,341,699	8,832,323	283,517	13,457,539
Ditë-vonesa mbi 2 vite	5,984,478	13,997,415	384,555	20,366,448
Totali	**60,172,026**	**90,808,260**	**1,444,628**	**152,424,914**

	Hua për klientët			
31 dhjetor 2013	**Individë**	**Korporata**	**Paradhënie**	**Total i kredive**
Ditë-vonesa deri në 31 ditë	23,744,989	32,906,292	415,842	57,067,123
Ditë-vonesa 32-60 ditë	9,956,652	17,191,408	251,268	27,399,328
Ditë-vonesa 61-90 ditë	11,763,344	15,336,162	393,839	27,493,345
Ditë-vonesa 91-180 ditë	4,948,616	8,268,727	70,808	13,288,151
Ditë-vonesa 181 ditë - 365 ditë	6,197,129	20,218,937	357,697	26,773,763
Ditë-vonesa 1-2 vite	3,264,641	16,990,811	83,329	20,338,781
Ditë-vonesa mbi 2 vite	4,837,391	13,338,243	364,558	18,540,192
Totali	**64,712,762**	**124,250,580**	**1,937,341**	**190,900,683**

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Më poshtë paraqitet një analizë e kolateralit dhe e garancive të tjera për kreditë gjatë vitit:

		Hua për klientët	
31 dhjetor 2014	**Individë**	**Korporata**	**Total i kredive**
Ndertesa rezidenciale, tregtare ose industriale	742,130,430	1,087,673,589	1,829,804,019
Aktive financiare	20,767,879	159,522,709	180,290,588
Të tjera	63,128,008	176,832,726	239,960,734
Totali	**826,026,317**	**1,424,029,024**	**2,250,055,341**

		Hua për klientët	
31 dhjetor 2013	**Individë**	**Korporata**	**Total i kredive**
Ndertesa rezidenciale, tregtare ose industriale	798,889,479	1,067,778,384	1,866,667,863
Aktive financiare	25,629,305	237,331,108	262,960,413
Të tjera	44,818,518	204,748,961	249,567,479
Totali	**869,337,302**	**1,509,858,453**	**2,379,195,755**

Cilësia e aktiveve të tjera finanicare, bazuar në sistemin e vlerësimit të brendshëm të Bankës paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2014	**Bono thesari**	**Llogari me bankat e tjera**	**Portofoli i vlefshëm për tu shitur**	**Portofoli i mbajtur deri në maturim**	**Totali**
Mirë	276,418,401	312,635,565	745,191,900	198,822,024	1,533,067,890
Pranueshëm	-	-	-	-	-
Nën monitorim	-	-	-	-	-
Totali	**276,418,401**	**312,635,565**	**745,191,900**	**198,822,024**	**1,533,067,890**

31 dhjetor 2013	**Bono thesari**	**Llogari me bankat e tjera**	**Portofoli i vlefshëm për tu shitur**	**Portofoli i mbajtur deri në maturim**	**Totali**
Mirë	236,724,368	322,930,740	697,179,575	217,755,420	1,474,590,103
Pranueshëm	-	-	-	-	-
Nën monitorim	-	-	-	-	-
Totali	**236,724,368**	**322,930,740**	**697,179,575**	**217,755,420**	**1,474,590,103**

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Bonot e thesarit, investimet e vlefshme për tu shitur, dhe investimet e mbajtura deri në maturim ndahen si më poshtë:

Vlerësimi i Moody's ose ekuivalente te tij	**Shënime**	**31 dhjetor 2014**	**31 dhjetor 2013**
Obligacione të qeverisë dhe bonot e thesarit	**9,10,11**		
Vlerësuar A2 në Aa1		-	7,284,168
Vlerësuar Baa3 në Baa1		5,999,661	23,001,535
Vlerësuar Ba3 në Ba1		30,960,279	35,653,642
Vlerësuar B2 në B1		779,136,509	710,196,189
Të pavlerësuara		60,162,111	7,520,709
Obligacione të korporatave dhe letra me vlerë të kolateralizuara	**10,11**		
Vlerësuar Baa3 në Baa1		85,894,224	93,850,379
Vlerësuar Ba3 në Ba1		9,830,436	9,169,587
Të pavlerësuara		6,197,751	3,472,047
Oblibacione të bankave	**10,11**		
Vlerësuar A3 në A1		-	4,343,666
Vlerësuar Baa3 në Baa1		83,976,117	107,984,117
Vlerësuar Ba2 në Ba1		82,774,696	58,753,506
Vlerësuar Ba3		11,462,093	3,071,900
Vlerësuar B2 në B1		32,867,968	24,337,913
Të pavlerësuara		6,088,361	32,763,016
Investime në kapital			
Të pavlerësuara		25,082,119	30,256,989
Totali		**1,220,432,325**	**1,151,659,363**

Vlerësimi për huatë për klientët detajohet në shënimin 12.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë sipas sektorit dhe pozicionit gjeografik. Një analizë e përqendrimit të rrezikut te kredisë nga huatë dhe letrat me vlerë në 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet më poshtë:

	Shënimi	Huatë për klientët		Huatë për bankat		Investimet në letra me vlerë	
		2014	**2013**	**2014**	**2013**	**2014**	**2013**
Vlera kontabël	9-11,12,13	920,268,253	886,202,417	173,290,510	121,650,866	1,220,432,325	1,151,659,363
Përqëndrimi sipas sektorit							
Korporata		637,834,184	589,813,727	-	-	127,004,530	136,749,002
Qeveri		4,726,885	2,513,624	-	-	876,258,560	783,656,243
Banka		-	-	173,290,510	121,650,866	217,169,235	231,254,118
Individë		277,707,184	293,875,066	-	-	-	-
Totali		**920,268,253**	**886,202,417**	**173,290,510**	**121,650,866**	**1,220,432,325**	**1,151,659,363**

Përqëndrimi sipas shtetit	**Shënimi**	**Huatë për klientët**		**Huatë për bankat**		**Investimet në letra me vlerë**	
		2014	**2013**	**2014**	**2013**	**2014**	**2013**
Shqipëria		615,583,145	645,257,574	-	-	779,136,509	710,196,188
Kosova		150,898,845	132,207,055	-	-	60,162,111	7,520,709
Evropa		109,032,758	88,631,921	162,220,209	121,650,866	329,503,551	414,537,222
Azia		-	-	6,055,750	-	27,150,109	14,003,811
Lindja e Mesme dhe Afrika		44,753,505	20,105,867	5,014,551	-	12,293,462	5,401,433
Amerika e Jugut		-	-	-	-	12,186,583	-
Totali	9-11,12,13	**920,268,253**	**886,202,417**	**173,290,510**	**121,650,866**	**1,220,432,325**	**1,151,659,363**

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të ndeshë vështirësi në përmbushjen e angazhimeve të saj të lidhura me detyrimet financiare që shlyhen përmes mjeteve monetare apo një aktivi tjetër financiar.
Qëllimi i Menaxhimit të Rrezikut të Likuiditetit (MRL) është që të sigurojë, për aq sa është e mundur, se Banka do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer të gjitha detyrimet për pagesë në afatin e tyre, si në kushte normale ashtu dhe në situata tensioni, pa krijuar humbje të papranueshme, apo duke rrezikuar dëm në reputacion të Bankës. Politika MRL e Bankës përfshin mënyrën se si Banka e identifikon, mat, monitoron dhe e kontrollon këtë rrezik.

Organizimi i MRL: Organizimi i MRL në Bankë përfshin dy organizma të ndryshëm në monitorimin dhe menaxhimin e likuiditetit. Përfshirja e organizmave të ndryshëm ndihmon në një shpërndarje më të qartë të përgjegjësive për monitorimin/raportimin dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Menaxhimi ditor i likuiditetit i përket Thesarit, por monitorimi ditor i rrezikut të likuiditetit dhe përputhja me limitet i përket Grupit të Menaxhimit të Riskut. Qëllimi kryesor i Grupit të Menaxhimit të Riskut, i cili ushtron kontrollin ditor të raporteve MRL, është që ti japë sinjale të hershme menaxhimit të lartë të Bankës për paralajmërimin e rrezikut të likuiditetit.

Raportet MRL: Politika MRL e Bankës përfshin grupe raportesh ditore dhe mujore për t'u parë dhe kontrolluar nga Departamenti i Rrezikut të Tregut dhe Operacional. Raportet ditore përfshijnë tabelën e Daljeve Maksimale Kumulative dhe tabelën e Ndarjes Kumulative të Aktiveve dhe Pasiveve, të cilat kontrollojnë përkatësisht hyrjet/daljet ditore dhe mujore të likuiditetit deri në maturitetin 1 vit sipas skenarit "biznes normal". Raportet mujore përfshijnë tabelat e likuiditetit për testet e stresit, të cilat kontrollojnë hyrjet/daljet ditore dhe mujore të likuiditetit sipas skenarëve të veçantë për kriza të Bankës dhe të tregut deri në maturitetin 3 muaj.

Përqasja MRL e Bankës më 31 dhjetor 2014 rezulton me hendek likuiditeti pozitiv për të gjithë grupet kohore deri në një vit. Kjo ka ndodhur kryesisht për këto tre supozime:

- Duke përdorur metodën statistikore dhe të dhënat historike (derivuar që nga viti 2001) raporti i MRL-së aktuale përfshin analiza bazuar në modelin e sjelljes së ri-investimit të depozitave;
- Investimet afat-shkurta të mbajtura për tregtim konsiderohen likuide prej financimit të siguruar nga Banka e Shqipërisë;
- Kërkesat e mbajtjes se rezervës me BSH konsiderohen si aktive jo-likuide.

Më poshtë paraqitet një analizë e pritshme e flukseve monetare të Bankës sipas maturitet të mbetur.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2014, aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës kanë maturitet kontraktual të mbetur si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Aktive						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	227,950,918	-	-	-	-	227,950,918
Depozita dhe llogaritë me bankat	122,611,769	7,837,533	8,895,753	-	-	139,345,055
Bono thesari	53,772,139	89,303,204	133,343,058	-	-	276,418,401
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	15,124,593	9,388,219	140,292,244	393,464,746	186,922,098	745,191,900
Investime të mbajtura deri në maturim	5,589,981	34,903,276	68,517,308	88,798,437	1,013,022	198,822,024
Hua për bankat	78,114	33,574,192	134,773,499	4,864,705	-	173,290,510
Hua për klientët	47,552,806	48,531,391	229,029,904	384,528,780	210,625,372	920,268,253
Investime në pjesëmarrje	-	-	-	-	1,458,925	1,458,925
Aktive të tjera	11,449,980	-	26,168,034	-	6,842,608	44,460,622
Totali aktiveve	**484,130,300**	**223,537,815**	**741,019,800**	**871,656,668**	**406,862,025**	**2,727,206,608**
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	696,138,879	273,741,333	960,425,491	192,883,838	17,629,444	2,140,818,985
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	244,075,173	58,513,608	2,987,857	18,583,175	2,754,639	326,914,452
Detyrime ndaj palëve të treta	2,123,604	-	-	-	-	2,123,604
Detyrime tatimore të shtyra	-	-	-	1,846,611	-	1,846,611
Detyrime të tjera	14,942,095	-	-	-	1,052,804	15,994,899
Borxhi varur	-	-	44,615	12,161,763	6,080,882	18,287,260
Totali i detyrimeve	**957,279,751**	**332,254,941**	**963,457,963**	**225,475,387**	**27,517,769**	**2,505,985,811**
Rreziku i likuiditetit	**(473,149,451)**	**(108,717,126)**	**(222,438,163)**	**646,181,281**	**379,344,256**	**221,220,797**
Kumulative	**(473,149,451)**	**(581,866,577)**	**(804,304,740)**	**(158,123,459)**	**221,220,797**	

Raportet MRL prodhohen për secilën monedhë Lek, Euro dhe USD dhe për totalin e pozicionit financiar gjithashtu. Limitet kumulative maksimale te flukseve dalese, të cilat menaxhohen dhe monitorohen në baza ditore, janë caktuar për secilën nga monedha e mësipërme.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2013, aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës kanë maturitet kontraktual të mbetur si më poshtë:

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Aktive						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	237,473,002	-	-	-	-	237,473,002
Depozita dhe llogaritë me bankat	174,861,169	22,408,966	4,009,739	-	-	201,279,874
Bono thesari	56,476,281	95,237,882	85,010,205	-	-	236,724,368
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	829,966	44,735,106	155,381,622	397,579,329	98,653,552	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	15,561,509	25,483,707	77,023,207	98,671,808	1,015,189	217,755,420
Hua për bankat	16,886	15,086,920	67,778,489	38,768,571	-	121,650,866
Hua për klientët	120,846,826	30,909,223	196,588,657	340,070,792	197,786,919	886,202,417
Investime në filiale	-	-	-	-	1,651,128	1,651,128
Aktive të tjera	11,793,932	547,605	26,691,903	-	7,613,994	46,647,434
Totali aktiveve	**617,859,571**	**234,409,409**	**612,483,822**	**875,090,500**	**306,720,782**	**2,646,564,084**
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	654,012,811	337,450,625	1,003,914,886	149,714,082	9,172,992	2,154,265,396
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	240,722,237	11,482,006	2,752,798	20,900,618	2,498,164	278,355,823
Detyrime ndaj palëve të treta	1,738,013	-	-	-	-	1,738,013
Detyrime tatimore të shtyra	-	-	-	3,264,859	-	3,264,859
Detyrime të tjera	8,255,564	-	-	-	1,099,870	9,355,434
Borxhi varur	-	-	32,874	-	13,763,990	13,796,864
Totali i detyrimeve	**904,728,625**	**348,932,631**	**1,006,700,558**	**173,879,559**	**26,535,016**	**2,460,776,389**
Rreziku i likuiditetit	**(286,869,054)**	**(114,523,222)**	**(394,216,736)**	**701,210,941**	**280,185,766**	**185,787,695**
Kumulative	**(286,869,054)**	**(401,392,276)**	**(795,609,012)**	**(94,398,071)**	**185,787,695**	

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Nje tregues kryesor që përdoret nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit, i cili, në të njëjtën kohë kërkohet nga Banka e Shqipërisë, është raporti i aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtër në baza ditore. Bazuar në rregulloren Nr.71 date 14.10.2009 "Politika e administrimit të rrezikut të likuiditetit", ndryshuar me vendimin nr. 75 datë 26.10.2011, ky raport duhet të jetë minimalisht 25%, ndërkohë që vlera minimale e treguesve individualë për monedhën vëndase dhe atë të huaj (FX) është 20%. Ndërkohë, bazuar në ndryshimet e fundit të kësaj rregulloreje, në fuqi prej 15 maj 2013, treguesi total i raportit të likuiditetit duhet të jetë minimalisht 20%, ndërkohë që treguesit individualë duhet të jenë minimalisht 15%.

Sipas kësaj rregulloreje, Neni 19, pika 4, aktivet likuide janë konsideruar: balancat e mjeteve monetare, llogaritë rrjedhëse me BSH, duke përfshirë rezervën e detyrueshme, Bonot e thesarit dhe investimet bazuar në maturitetin e mbetur dhe aftësinë për tu bërë likuide, ku balancat me palët jo rezidente skontohen me normat përkatëse sipas renditjeve ndërkombëtare. Detyrimet afat-shkurta konsiderohen të gjitha detyrimet me maturitet të mbetur deri në një vit.

Detajet për raportet e Bankës në datat e raportimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	**31 dhjetor 2013**
Raporti i Aktiveve likuide/Detyrimet afat-shkurta	35.27%	32.67%
Raporti i Aktiveve likuide në monedhën lokale/Detyrimet afat-shkurtra në monedhën lokale	50.65%	38.23%
Raporti i Aktiveve likuide në monedhë të huaj/Detyrimet afat-shkurtra në monedhë të huaj	20.48%	27.15%

(d) Rreziqet e tregut

1) Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i monedhës së huaj është rreziku sipas të cilit, vlera e instrumenteve financiare luhatet në sajë të ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor. Banka e menaxhon këtë rrezik duke vendosur dhe monitoruar limitet mbi pozicionet e hapura dhe gjithashtu duke u siguruar që këto pozicione të jenë në përputhje me udhëzimet e Bankës së Shqipërisë dhe kufijve të brendshëm operacionale të Bankës. Banka ka vendosur procedura për një kontroll të pavarur të pozicioneve të hapura në monedhë të huaj.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

1) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Tabelat më poshtë paraqesin shumat ekuivalente të aktiveve dhe detyrimeve monetare sipas monedhave më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013:

31 dhjetor 2014	*Lek*	*USD*	*Euro*	*Të tjera*	*Total*
Aktivet			*(Në ekuivalentin në USD)*		
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	94,322,807	14,709,439	111,350,791	7,567,881	227,950,918
Depozita dhe llogaritë me bankat	229,220	61,857,406	55,552,176	21,706,253	139,345,055
Bono thesari	228,195,053	-	48,223,348	-	276,418,401
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	463,922,877	106,791,956	99,044,795	75,432,272	745,191,900
Investime të mbajtura deri në maturim	46,772,601	68,263,545	83,785,878	-	198,822,024
Hua për bankat	-	11,070,301	162,220,209	-	173,290,510
Hua për klientët	439,547,928	78,015,475	402,349,499	355,351	920,268,253
Investime në filiale	-	-	1,458,925	-	1,458,925
Aktive të tjera	30,085,704	169,099	9,456,678	4,749,141	44,460,622
Totali aktiveve	**1,303,076,190**	**340,877,221**	**973,442,299**	**109,810,898**	**2,727,206,608**
Kontratat e kursit të këmbimit	**852,035**	**112,139,390**	**105,796,728**	**46,761,519**	**265,549,672**
Detyrimet					
Detyrime ndaj klientëve	1,073,027,227	113,729,515	929,463,656	24,598,587	2,140,818,985
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	223,090,535	41,217,734	47,224,934	15,381,249	326,914,452
Detyrime ndaj palëve të treta	2,123,604	-	-	-	2,123,604
Detyrime tatimore të shtyra	1,846,611	-	-	-	1,846,611
Detyrime të tjera	8,759,555	4,426,757	2,180,641	627,946	15,994,899
Borxhi i varur	-	-	18,287,260	-	18,287,260
Totali i detyrimeve	**1,308,847,532**	**159,374,006**	**997,156,491**	**40,607,782**	**2,505,985,811**
Kontratat e kursit të këmbimit	**-**	**86,171,402**	**70,158,164**	**109,220,106**	**265,549,672**
Pozicioni neto (GAP)	(4,919,307)	207,471,203	11,924,372	6,744,529	221,220,797
Aktivet totale / totali i detyrimeve	99.62%	184.49%	101.12%	104.50%	107.98%
GAP / Aktivet në monedhë të huaj		0.46	0.011	0.0431	0.07
Analiza e ndjeshmërisë					
Lek zhvlerësohet me 10%		18,861,018	1,084,034	613,139	20,558,191
Lek zhvlerësohet me 5%		9,879,581	567,827	321,168	10,768,576
Lek vlerësohet me 5%		(10,919,537)	(627,599)	(354,975)	(11,902,111)
Lek vlerësohet me 10%		(23,052,356)	(1,324,930)	(749,392)	(25,126,678)

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

1) Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

31 dhjetor 2013	*Lek*	*USD*	*Euro*	*Të tjera*	*Total*
Aktivet			*(Në ekuivalentin në USD)*		
Arka dhe llogari me Bankën Qendrore	88,398,635	14,054,276	131,691,494	3,328,597	237,473,002
Depozita dhe llogaritë me bankat	503,524	34,692,695	151,616,453	14,467,202	201,279,874
Bono thesari	229,203,659	-	7,520,709	-	236,724,368
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	365,916,891	131,970,458	96,623,675	102,668,551	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	81,047,193	38,444,508	98,263,719	-	217,755,420
Hua për bankat	-	3,017,936	118,632,930	-	121,650,866
Hua për klientët	474,788,271	67,968,196	342,888,136	557,814	886,202,417
Investime në filiale	-	-	1,651,128	-	1,651,128
Aktive të tjera	28,791,579	421,960	11,331,927	6,101,968	46,647,434
Totali aktiveve	**1,268,649,752**	**290,570,029**	**960,220,171**	**127,124,132**	**2,646,564,084**
Kontratat e kursit të këmbimit	**3,533,708**	**93,419,603**	**117,801,192**	**67,970,719**	**282,725,222**
Detyrimet					
Detyrime ndaj klientëve	1,077,306,152	122,734,529	930,366,459	23,858,256	2,154,265,396
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	195,861,186	12,851,246	40,329,888	29,313,503	278,355,823
Detyrime ndaj palëve të treta	1,738,013	-	-	-	1,738,013
Detyrime tatimore të shtyra	3,264,859	-	-	-	3,264,859
Detyrime të tjera	3,755,457	3,715,804	1,661,830	222,343	9,355,434
Borxhi i varur	-	-	13,796,864	-	13,796,864
Totali i detyrimeve	**1,281,925,667**	**139,301,579**	**986,155,041**	**53,394,102**	**2,460,776,389**
Kontratat e kursit të këmbimit	**-**	**72,646,335**	**79,369,972**	**130,708,915**	**282,725,222**
Pozicioni neto (GAP)	(9,742,207)	172,041,718	12,496,350	10,991,834	185,787,695
Aktivet totale / totali i detyrimeve	99.24%	181.17%	101.17%	105.97%	106.77%
GAP / Aktivet në monedhë të huaj		0.45	0.012	0.0563	0.06
Analiza e ndjeshmërisë					
Lek zhvlerësohet me 10%		15,640,156	1,136,032	999,258	17,775,446
Lek zhvlerësohet me 5%		8,192,463	595,064	523,421	9,310,948
Lek vlerësohet me 5%		(9,054,827)	(657,703)	(578,518)	(10,291,048)
Lek vlerësohet me 10%		(19,115,746)	(1,388,483)	(1,221,315)	(21,725,544)

2) Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhatet në varësi të ndryshimeve të normave të interesit të tregut. Departamenti i Thesarit i Bankës e menaxhon rrezikun e normës së interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe duke ndërmarrë vendime të nevojshme për ripërcaktimin e çmimit ose rialokimin e investimeve pas miratimit të Komitetit të Aktiveve dhe Pasiveve. Analiza e ndjeshmërisë është bërë bazuar në ekspozimin e normës së interesit për aktivet dhe detyrimet financiare, duke supozuar që vlerat e mbetura në datën e raportimit ishin po aq gjatë të gjithë vitit.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Norma mesatare efektive e ponderuar e kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës në 31 dhjetor 2014 paraqitet më poshtë:

	Lek	*USD*	*Euro*
Aktivet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	1.58%	N/A	N/A
Depozita dhe llogaritë me bankat	2.60%	0.65%	1.92%
Bono thesari	3.53%	N/A	1.98%
Investime ne letra me vlere	6.33%	4.61%	3.68%
Hua për bankat	N/A	4.93%	0.83%
Hua për klientët	7.06%	7.38%	7.39%
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	2.27%	1.10%	1.02%
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	2.25%	1.49%	1.54%
Borxhi i varur	-	-	5.18%

Norma mesatare efektive e ponderuar e kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës në 31 dhjetor 2013 paraqitet më poshtë:

	Lek	*USD*	*Euro*
Aktivet			
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	2.10%	N/A	N/A
Depozita dhe llogaritë me bankat	3.05%	3.56%	0.43%
Bono thesari	5.79%	N/A	1.70%
Investime ne letra me vlere	7.53%	4.84%	4.66%
Hua për bankat	N/A	3.51%	1.76%
Hua për klientët	8.75%	7.39%	7.93%
Detyrimet			
Detyrime ndaj klientëve	3.84%	1.85%	1.90%
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	3.02%	0.95%	2.28%
Borxhi i varur	-	-	5.37%

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Datat e ri-çmimit të interesit të kategorive të rëndësishme për aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës më 31 dhjetor 2014 paraqiten më poshtë:

	Deri në 1 muaj	*1-3 muaj*	*3-12 muaj*	*1-5 vite*	*Mbi 5 vite*	*Totali*
Aktivet						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	227,950,918	-	-	-	-	227,950,918
Depozita dhe llogaritë me bankat	122,611,769	7,837,533	8,895,753	-	-	139,345,055
Bono thesari	53,772,139	89,303,204	133,343,058	-	-	276,418,401
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	15,744,058	9,998,982	142,436,883	390,577,179	186,434,798	745,191,900
Investime të mbajtura deri në maturim	5,589,983	43,762,102	63,599,327	84,870,612	1,000,000	198,822,024
Hua për bankat	36,563,404	127,578,227	9,148,879	-	-	173,290,510
Hua për klientët	616,213,977	35,772,392	198,463,501	57,425,246	12,393,137	920,268,253
Totali	**1,078,446,248**	**314,252,440**	**555,887,401**	**532,873,037**	**199,827,935**	**2,681,287,061**
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	696,138,878	273,741,333	960,425,491	192,883,839	17,629,444	2,140,818,985
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	244,075,174	70,675,371	12,163,907	-	-	326,914,452
Borxhi i varur	-	-	18,287,260	-	-	18,287,260
Totali	**940,214,052**	**344,416,704**	**990,876,658**	**192,883,839**	**17,629,444**	**2,486,020,697**

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Datat e ri-çmimit të interesit të kategorive të rëndësishme për aktivet dhe detyrimet financiare të Bankës më 31 dhjetor 2013 paraqiten më poshtë:

	Deri në 1 muaj	*1-3 muaj*	*3-12 muaj*	*1-5 vite*	*Mbi 5 vite*	*Totali*
Aktivet						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	237,473,002	-	-	-	-	237,473,002
Depozita dhe llogaritë me bankat	174,861,169	22,408,966	4,009,739	-	-	201,279,874
Bono thesari	56,476,280	95,237,882	85,010,206	-	-	236,724,368
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	803,955	46,417,643	155,971,643	396,322,011	97,664,323	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	15,561,509	25,516,487	77,525,536	98,151,888	1,000,000	217,755,420
Hua për bankat	8,275,280	84,154,071	29,221,515	-	-	121,650,866
Hua për klientët	656,917,757	20,623,823	149,202,181	52,411,413	7,047,243	886,202,417
Totali	**1,150,368,952**	**294,358,872**	**500,940,820**	**546,885,312**	**105,711,566**	**2,598,265,522**
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	654,012,811	337,450,625	1,003,914,886	149,714,082	9,172,992	2,154,265,396
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	240,722,236	37,633,587	-	-	-	278,355,823
Borxhi i varur	-	-	13,796,864	-	-	13,796,864
Totali	**894,735,047**	**375,084,212**	**1,017,711,750**	**149,714,082**	**9,172,992**	**2,446,418,083**

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziqet e tregut (vazhdim)

2) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Ndjeshmëria e normës së interesit

Analiza e ndjeshmërisë paraqitur më poshtë është përgatitur bazuar në ekspozimin e normave të interesit në datën e raportimit dhe ndryshimit të supozuar në fillim të vitit financiar dhe të mbajtur konstant gjatë gjithë periudhës. Më poshtë paraqitet efekti në fitimin neto i ndryshimit të normave të interesit, kur ndryshimi është aplikuar në pozicionin e hapur sipas periudhave të ri-çmimit të interesit të paraqitur në shënimin më sipër, duke supozuar që të gjithë variablat e tjerë mbahen konstant:

	31 dhjetor 2014		*31 dhjetor 2013*	
	deri në 1 vit	**mbi 1 vit**	**deri në 1 vit**	**mbi 1 vit**
Rritja e normës së interesit me 2%	(278,393)	10,165,361	(1,720,569)	8,153,627
Rritja e normës së interesit me 1.5%	(208,795)	7,624,021	(1,290,426)	6,115,221
Rritja e normës së interesit me 1%	(139,197)	5,082,680	(860,284)	4,076,814
Zvogëlimi i normës së interesit me 1%	139,197	(5,082,680)	860,284	(4,076,814)
Zvogëlimi i normës së interesit me 1.5%	208,795	(7,624,021)	1,290,426	(6,115,221)
Zvogëlimi i normës së interesit me 2%	278,393	(10,165,361)	1,720,569	(8,153,627)

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proçeset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kredisë, tregut dhe likuiditetit si p.sh ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatore si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuara të sjelljes se korporatave. Rreziqet operacionale lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës.

Objektivi i Bankës është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me efektivitetin e përgjithshëm të kostove, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Implementimi i kontrolleve për të adresuar rrezikun operacional mbështetet nga zhvillimi i standardeve të administrimit te rrezikut të operacioneve si më poshtë:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të veprimeve
- kërkesa për rakordimin dhe monitorimin e Veprimeve
- pajtimi me kërkesat dhe rregullat ligjore
- dokumentimi i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale të identifikuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimi rregullues i propozuar
- zhvillimi i planeve mbuluese
- zhvillimi trajnues dhe profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlimi i riskut, duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

Përputhshmëria me standardet e brendshme është mbeshtetur nga një program rishikimesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i Brendshëm. Rezultat e Auditimit të Brendshëm janë diskutuar me administrimin e njësisë se biznesit me të cilën ato lidhen, me përmbledhje të dërguara Komitetit të Auditimit dhe Drejtimit të Bankës.

5. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Administrimi i kapitalit

Politika e Bankës është të mbajë një bazë kapitali të fortë për të mbajtur besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe për të mbështetur zhvillimet e ardhme të biznesit. Njihet ndikimi i nivelit të kthimit prej kapitalit aksionar, dhe Banka njeh gjithashtu nevojën për të mbajtur ekuilibrat ndërmjet kthimeve të larta që mund të jenë të mundura me nivel më të lartë huaje dhe avantazheve dhe sigurisë që ofron një pozicion i fortë i kapitalit. Nuk ka pasur ndryshime materiale në administrimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës.

Kapitali rregullator

Banka e monitoron përshtatshmërinë e kapitalit, përveç masave të tjera, nëpërmjet përdorimit të rregulloreve dhe raporteve të vendosura nga Rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë ("BSH") e cila përcakton kapitalin regullator të kërkuar për të mbështetur biznesin. Rregullorja "Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit" është mbështetur në ligjin Nr. 8269, datë 23.12.1997 "Mbi Bankën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 9662, datë 18.12.2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Mjaftueshmëria e kapitalit

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara me rrezikun dhe llogaritë jashtë-bilancit, i shprehur në përqindje. Minimumi i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit që kërkohet nga Banka e Shqipërisë është 12%, ndërkohë që Banka e ka mbajtur këtë normë në 15.6% në 31 dhjetor 2014 (2013: 14.6%).

Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit bazë me aktivet e ponderuara me rrezikun dhe llogaritë jashtë-bilancit, i shprehur në përqindje. Minimumi i raportit të modifikuar të mjaftueshmërisë së kapitalit është 6%, ndërkohë që Banka e ka mbajtur këtë normë në 14.4% në 31 dhjetor 2014 (2013: 13.5%).

Aktivet e ponderuara me Rrezikun

Aktivet janë të ponderuara sipas kategorive dhe rrezikut, duke i caktuar një risk të ponderuar sipas shumës së kapitalit të nevojshem për të mbështetur atë. Pesë kategoritë e rrezikut janë 0%, 20%, 50%, 100%, 150%; për shembull mjetet monetare dhe instrumentet e tregut financiar kane rrezik të ponderuar zero sipas Bankës së Shqipërisë, që do të thotë qe nuk ka nevojë për kapital për të mbajtur këto aktive. Mjetet afatgjata të trupëzuara mbartin 100% risk të ponderuar, që do të thotë se një kapital prej 12% i vlerës së tyre kontabël duhet t'i mbështesë.

Kreditë jashtë-bilancit që lidhen me angazhime të marra, merren në konsideratë. Shumat ponderohen për rrezikun duke përdorur të njëjtat përqindje si për zërat e aktiveve.

Përputhshmëria

Banka dhe operacionet e saj individuale të rregulluara, janë në përputhje me kërkesat e brendshme dhe të jashtme për kapital gjatë vitit.

6. Raportimi i segmenteve

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
Segmentet Gjeografike	**Shqipëria**	**Kosova**	**I konsoliduar**	**Shqipëria**	**Kosova**	**I konsoliduar**
Aktivet						
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	183,697,203	44,253,715	227,950,918	177,969,351	59,503,651	237,473,002
Depozita dhe llogaritë me bankat	138,840,835	504,220	139,345,055	201,073,192	206,682	201,279,874
Bono thesari	229,604,013	46,814,388	276,418,401	229,217,218	7,507,150	236,724,368
Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim	731,888,733	13,303,167	745,191,900	697,179,575	-	697,179,575
Investime të mbajtura deri në maturim	198,822,024	-	198,822,024	217,755,420	-	217,755,420
Hua për bankat	173,290,510	-	173,290,510	121,650,866	-	121,650,866
Hua për klientët	769,369,408	150,898,845	920,268,253	753,995,362	132,207,055	886,202,417
Investime në filiale	1,458,925	-	1,458,925	1,651,128	-	1,651,128
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	19,861,924	4,321,474	24,183,398	22,309,339	5,633,128	27,942,467
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	1,230,590	-	1,230,590	1,235,689	-	1,235,689
Aktive të tjera	5,763,277	38,697,345	44,460,622	(51,159,450)	97,806,884	46,647,434
Totali aktiveve	**2,453,827,442**	**298,793,154**	**2,752,620,596**	**2,372,877,690**	**302,864,550**	**2,675,742,240**
Detyrimet dhe kapitali aksionar						
Detyrimet						
Detyrime ndaj klientëve	1,882,396,886	258,422,099	2,140,818,985	1,884,959,892	269,305,504	2,154,265,396
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	314,740,524	12,173,928	326,914,452	271,457,353	6,898,470	278,355,823
Detyrime ndaj palëve të treta	2,123,604	-	2,123,604	1,738,013	-	1,738,013
Detyrime tatimore të shtyra	1,846,611	-	1,846,611	3,264,859	-	3,264,859
Detyrime të tjera	13,776,000	2,218,899	15,994,899	8,317,842	1,037,592	9,355,434
Borxhi i varur	18,287,260	-	18,287,260	13,796,864	-	13,796,864
Totali detyrimeve	**2,233,170,885**	**272,814,926**	**2,505,985,811**	**2,183,534,823**	**277,241,566**	**2,460,776,389**
Kapitali aksionar						
Kapitali i aksionar i paguar			166,403,900			138,965,905
Rezerva Ligjore			-			-
Rezerva e konvertimit			(3,403,714)			1,140,491
Rezerva e vlerës së tregut			(3,835,505)			(3,196,237)
Fitimi i pashpërndarë			87,470,104			78,055,692
Totali i kapitalit aksionar			**246,634,785**			**214,965,851**
Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar			**2,752,620,596**			**2,675,742,240**

Shuma prej 36,396,029 USD, përfaqëson transaksione brenda grupit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe Degëve në Shqipëri dhe Degës së Kosovës më 31 dhjetor 2014 dhe është eleminuar gjatë konsolidimit (31 dhjetor 2013: 95,562,491 USD).

6. Raportimi i segmenteve (vazhdim)

Segmentet Gjeografike	**2014**			**2013**		
	Shqipëria	**Kosova**	**I konsoliduar**	**Shqipëria**	**Kosova**	**I konsoliduar**
Interesi						
Të ardhura nga interesi	126,537,064	17,225,600	143,762,664	135,188,077	16,751,005	151,939,082
Shpenzime interesi	(49,607,235)	(4,326,072)	(53,933,307)	(67,490,029)	(7,534,049)	(75,024,078)
Të ardhura nga interesi, neto	**76,929,829**	**12,899,528**	**89,829,357**	**67,698,048**	**9,216,956**	**76,915,004**
Të ardhura të tjera neto nga veprimtaria bankare						
Tarifa dhe komisione, neto	8,611,121	3,020,767	11,631,888	6,234,447	3,322,961	9,557,408
Fitimi/(humbja) neto nga rivlerësimi i valutave	5,621,801	2,012	5,623,813	(4,035,440)	15	(4,035,425)
Fitimi/(humbja) neto nga këmbimet valutore	(5,968,481)	(133,805)	(6,102,286)	(1,557,849)	(65,348)	(1,623,197)
(Humbja)/fitimi neto nga tregtimi investimeve	(1,189,395)	-	(1,189,395)	1,645,526	-	1,645,526
Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto	3,876,849	(23,824)	3,853,025	10,741,940	1,803	10,743,743
Totali i të ardhurave të tjera neto nga veprimtaria bankare	**10,951,895**	**2,865,150**	**13,817,045**	**13,028,624**	**3,259,431**	**16,288,055**
Shpenzime operative						
Shpenzime personeli	(14,348,687)	(4,264,194)	(18,612,881)	(12,883,320)	(4,221,818)	(17,105,138)
Shpenzime administrative	(18,053,110)	(4,736,968)	(22,790,078)	(16,157,317)	(4,817,287)	(20,974,604)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(3,541,117)	(1,297,508)	(4,838,625)	(3,320,773)	(1,769,561)	(5,090,334)
Totali i shpenzimeve operative	**(35,942,914)**	**(10,298,670)**	**(46,241,584)**	**(32,361,410)**	**(10,808,666)**	**(43,170,076)**
Zhvlerësimi i huave	(2,949,134)	(1,580,026)	(4,529,160)	(4,932,357)	(1,267,143)	(6,199,500)
Fitimi para tatimit	**48,989,676**	**3,885,982**	**52,875,658**	**43,432,905**	**400,578**	**43,833,483**
Tatimi mbi fitimin	(8,737,237)	(207,525)	(8,944,762)	(4,530,730)	-	(4,530,730)
Fitimi neto i vitit	**40,252,439**	**3,678,457**	**43,930,896**	**38,902,175**	**400,578**	**39,302,753**

Të ardhurat nga interesi prej 2,009,015 USD (2013: 1,787,428 USD), të cilat përfaqësojnë fitimin nga interesat nga dega e Kosovës si rezultat i veprimeve brenda grupit, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe Degëve në Shqipëri si dhe Degës së Kosovës, janë eliminuar gjatë konsolidimit.

7. Arka dhe llogari me Bankën Qendrore

Gjendjet e arkës dhe llogaritë me Bankën Qendrore më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Arka	47,514,034	39,442,451
Depozita me Bankën Qendrore të Kosovës	28,277,553	49,207,253
Banka e Shqipërisë		
Llogaria rrjedhëse	257,336	694,379
Rezerva e detyrueshme	151,867,461	148,077,326
Interesi i përllogaritur	34,534	51,593
	152,159,331	148,823,298
	227,950,918	**237,473,002**

Në përputhje me kërkesën e Bankës së Shqipërisë në lidhje me rezervën e detyrueshme, Banka duhet të mbajë një minimum në masën 10% të depozitave të klientëve në Shqipëri pranë Bankës së Shqipërisë, si llogari rezerve e detyrueshme, e cila gjatë muajit mund të përdoret deri në 60% të nivelit të saj, me kushtin që të ruhet mesatarja mujore.

Llogaritë me Bankën Qendrore në Kosovë përfshijnë rezervën e detyrueshme në masën 10% të depozitave të klientëve, si edhe depozitën e vendosur peng, ekuivalente me kapitalin e Kosovës.

Paraja dhe ekuivalentet e saj në 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore	227,950,918	237,473,002
Rezerva e detyrueshme në Shqipëri	(151,867,461)	(148,077,326)
Rezerva e detyrueshme në Kosovë	(21,259,553)	(23,019,592)
Depozitë ekuivalente me kapitalin e Kosovës	(8,513,234)	(9,634,793)
Llogaritë rrjedhëse me bankat	65,790,441	19,591,543
Interesi i përllogaritur me bankat	306,512	418,627
Depozitat me maturitet 3 muaj ose më pak	55,258,925	161,863,920
	167,666,548	**238,615,381**

8. Depozita dhe llogari me bankat

Depozita dhe llogari me bankat më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhen nga sa vijon:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Depozitat	68,264,888	176,837,103
Garanci në para mbajtur nga institucionet financiare	4,983,214	4,432,601
Llogaritë rrjedhëse	65,790,441	19,591,543
Interesi i përllogaritur	306,512	418,627
	139,345,055	**201,279,874**

Depozitat janë vendosur në bankat jo-rezidente nga vendet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (“OZhBE”) dhe kanë maturime kontraktuale deri në 1 vit. Llogaritë rrjedhëse paraqesin gjendjet me bankat korrespondente në vendet e OZhBE-së.

Garancia në para përfaqëson kryesisht kolateralin e mbajtur nga institucionet financiare në lidhje me disa letër kredish të lëshuara për klientët e Bankës, si dhe depozita në para për garantimin e rreziqeve, të cilat mund të shfaqen nga aktiviteti i Bankës lidhur me kartat e kreditit.

9. Bono thesari

Portofoli i bonove të thesarit përbëhet nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Bono thesari të vlefshme për shitje	276,418,401	236,724,368
	276,418,401	**236,724,368**

Bonot e thesarit të vlefshme për shitje sipas maturitetit origjinal më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2014			
	Vlera e blerjes	Skonto e amortizuar	Fitimi/(humbja) e tregut	Vlera e drejtë
3 muaj	28,581,355	10,634	(3,615)	28,588,374
6 muaj	28,097,573	124,588	39,768	28,261,929
12 muaj	215,010,982	4,577,576	(20,460)	219,568,098
	271,689,910	**4,712,798**	**15,693**	**276,418,401**

	31 dhjetor 2013			
	Vlera e blerjes	Skonto e amortizuar	Fitimi/(humbja) e tregut	Vlera e drejtë
3 muaj	1,768,353	598	108	1,769,059
6 muaj	8,666,145	87,410	6,682	8,760,237
12 muaj	216,359,950	9,128,739	706,383	226,195,072
	226,794,448	**9,216,747**	**713,173**	**236,724,368**

10. Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim

Portofoli i investimeve të vlefshme për tregtim dhe shitje të Bankës më 31 dhjetor 2014 përfshin investime të vlefshme për tregtim në shumën 5,999,661 USD (31 dhjetor 2013: zero) dhe investime të vlefshme për shitje në shumën 739,192,239 USD (31 dhjetor 2013: 697,179,575 USD).

Investime të vlefshme për tregtim dhe shitje më 31 dhjetor 2014 përbëhen nga sa më poshtë:

Tipi	**Vlera nominale**	**Skonto e paamortizuar**	**Interesi i përllogaritur**	**Fitimi (humbja) e tregut**	**Vlera e Tregut**
Letra me vlerë te emetuara në:					
LEK	456,530,832	191,859	7,245,216	(45,030)	463,922,877
USD	104,068,212	1,564,145	1,428,144	(268,545)	106,791,956
EUR	95,816,210	1,802,658	1,914,593	(488,666)	99,044,795
TRY	55,012,967	-	7,823,652	-	62,836,619
CAD	11,555,413	-	-	(3,006,217)	8,549,196
GBP	3,728,848	78,609	129,595	76,482	4,013,534
SEK	79,813	-	-	(46,890)	32,923
	726,792,295	**3,637,271**	**18,541,200**	**(3,778,866)**	**745,191,900**

10. Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim (vazhdim)

Në gusht 2014 Banka ka riklasifikuar disa investime nga të vlefshme për shitje në portofolin e investime të mbajtura deri në maturim. Vlera e drejtë prej 39,218,164 USD e portofolit të investimeve të vlefshme për shitje të riklasifikuara në datën e riklasifikimit, u bë kosto e amortizuar e portofolit të investimeve të mbajtura deri në maturim.

Investime të vlefshme për shitje dhe të mbajtura për tregtim më 31 dhjetor 2013 përbëhen nga sa më poshtë:

Type	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interesi i përllogaritur	Fitimi (humbja) e tregut	Vlera e Tregut
Letra me vlerë te emetuara në:					
LEK	355,468,105	272,922	6,299,647	3,876,217	365,916,891
USD	129,422,632	1,890,535	1,697,758	(1,040,467)	131,970,458
EUR	90,278,009	1,927,882	2,931,070	1,486,715	96,623,676
TRY	86,724,924	(43,769)	5,142,057	(4,475,360)	87,347,852
CAD	12,566,607	-	-	(3,678,859)	8,887,748
GBP	6,090,210	119,667	215,953	7,120	6,432,950
	680,550,487	**4,167,237**	**16,286,485**	**(3,824,634)**	**697,179,575**

11. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2014 përbëhen nga sa më poshtë:

Tipi	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interesi i përllogaritur	Vlera e Tregut
Letra me vlerë te emetuara në:				
LEK	45,994,966	2,827	774,808	46,772,601
USD	65,569,894	1,352,795	1,340,856	68,263,545
EUR	82,283,067	338,259	1,164,552	83,785,878
	193,847,927	**1,693,881**	**3,280,216**	**198,822,024**

Investimet e mbajtura deri në maturim më 31 dhjetor 2013 përbëhen nga sa më poshtë:

Tipi	Vlera nominale	Skonto e paamortizuar	Interesi i përllogaritur	Vlera e Tregut
Letra me vlerë te emetuara në				
LEK	79,198,070	6,888	1,842,235	81,047,193
USD	37,923,712	82,493	438,303	38,444,508
EUR	96,335,266	446,450	1,482,003	98,263,719
	213,457,048	**535,831**	**3,762,541**	**217,755,420**

12. Hua për bankat

Banka ka blerë kredi të përbashkëta (në sindikatë) prej disa bankave jo-rezidente dhe vlerësimi i tyre paraqitet më poshtë:

Moody's ose ekuivalentë të tjerë	**31 dhjetor 2014**	**31 dhjetor 2013**
Vlerësuar Baa3 në Baa1	137,259,755	59,124,561
Vlerësuar Ba2 në Ba1	13,400,855	36,514,785
Vlerësuar Ba3	3,043,236	12,427,280
Vlerësuar B2 në B1	11,070,301	8,946,891
Të pavlerësuar	8,516,363	4,637,349
	173,290,510	**121,650,866**

13. Hua për klientët

Huatë për klientët përbëhen nga sa më poshtë :

	31 dhjetor 2014	**31 dhjetor 2013**
Hua për klientët, bruto	945,243,177	908,528,043
Interesi i përllogaritur	7,167,299	8,704,282
Minus zhvlerësimi i huave	(27,904,718)	(26,877,330)
Minus të ardhurën e shtyrë nga komisionet	(4,237,505)	(4,152,578)
	920,268,253	**886,202,417**

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit për huatë paraqiten më poshtë:

	2014	**2013**
Më 1 janar	26,877,330	19,675,821
Shpenzimi neto për vitin	4,529,160	6,199,500
Diferenca nga konvertimi	(3,501,772)	1,002,009
Fondi në fund të vitit	**27,904,718**	**26,877,330**

Efekti i kredive të fshira gjatë vitit aktual përfshirë në zhvlerësimin e vitit është 91,674 USD.

Kreditë janë emetuar në Lek, Euro, USD, CHF dhe GBP dhe kanë norma interesi si më poshtë:

Kreditë në Lek	0.50% to 25.00%
Kreditë në Euro	0.50% to 22.00%
Kreditë në USD	1.58% to 11.50%
Kreditë në CHF	4.54% to 5.21%
Kreditë në GBP	3.00% to 3.00%

Banka ka dhënë pak kredi me normë minimale interesi siç tregohet më sipër, të cilat janë më të ulëta se normat që ofrohen përgjithësisht nga Banka, dhe janë të mbuluara me kolateral në mjete monetare ose i janë ofruar personelit në kushte të veçanta.

13. Hua për klientët (vazhdim)

Klasifikimi i kredive për korporatat sipas industrive paraqitet më poshtë:

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
	USD	**%**	**USD**	**%**
Tregti me shumicë	115,419,486	17%	100,667,527	16%
Overdraftet	87,513,829	12%	18,688,430	3%
Ndërtim	50,611,147	7%	63,549,488	11%
Prodhimi, shpërndarja e energjisë, e gazit dhe e ujit	45,462,695	7%	82,893,194	13%
Ndërmjetësim financiar	36,885,943	6%	41,012,105	7%
Tregti me pakicë	32,483,477	5%	34,097,476	6%
Pasuri e paluajtshme, qira dhe aktivite biznesi	29,681,139	5%	21,317,914	4%
Prodhimi i mallrave të tjera jo metalike	29,410,570	5%	35,955,531	6%
Të tjera për komunitetin, aktivitete sociale, personale	24,599,132	4%	19,244,791	3%
Prodhimi i mallrave ushqimorë, pijeve	23,696,895	4%	23,391,192	4%
Përpunim i metaleve bazë dhe të fabrikuar	15,416,079	2%	10,684,014	2%
Arsimi	13,772,342	2%	17,262,681	3%
Kredi personale	11,925,612	2%	8,046,355	1%
Hotele dhe Restorante	10,825,112	2%	13,617,873	2%
Prodhimi i gomës dhe produkteve plastike	5,279,368	1%	6,887,446	1%
Shëndeti dhe veprimtaritë sociale	4,600,841	1%	8,626,846	1%
Përpunimi i letrës dhe nënprodukteve të saj	4,177,399	1%	5,265,125	1%
Bujqësi, gjueti, pylltari	4,138,257	1%	15,127,617	3%
Transporti, magazinimi dhe telekomunikacioni	3,720,267	1%	4,352,514	1%
Prodhimi i drurit dhe produkteve të tij	3,348,508	1%	4,805,987	1%
Sektorë të tjerë	100,507,460	14%	65,478,757	11%
	653,475,558	**100%**	**600,972,863**	**100%**

Huatë për individë sipas llojit paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
	USD	**%**	**USD**	**%**
Blerje shtëpie	187,053,961	62%	200,197,318	62%
Rregullim shtëpie	25,288,577	9%	28,387,014	10%
Super Kredi	25,356,675	9%	20,636,930	7%
Overdrafte dhe karta krediti	16,252,243	6%	15,024,603	4%
Blerje dyqani	12,241,354	4%	13,960,174	5%
Rindërtim shtëpie	7,918,127	3%	9,829,137	4%
Financime për shtëpi	2,935,474	1%	3,618,398	2%
Pajisje teknike	746,912	1%	796,664	1%
Blerje makinash	403,745	1%	636,013	1%
Lloje të tjera	13,570,551	4%	14,468,929	4%
	291,767,619	**100%**	**307,555,180**	**100%**

14. Investime në pjesëmarrje

Investime në pjesëmarrje në vlerën 1,458,925 USD (31 dhjetorr 2013: 1,651,128) përfaqëson kundravlerën e investimit në shumën prej 1,199,600 EUR në kapitalin aksionar të kompanisë Albania Leasing Sh.a ("Kompania") me normë pjesëmarrje 29.99%. Kompania është regjistruar ligjërisht në 2 gusht 2013 (data e themelimit) si Shoqëri Anonime. Kompania mori Licensën nga Banka e Shqipërisë më 21 prill 2014 dhe filloi aktivitetin e saj të qiradhënies në qershor 2014.

15. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten më poshtë:

	Tokë, ndërtesa dhe përmirësim i ambjenteve me qira	Mjete transporti dhe pajisje të tjera	Kompjutera dhe pajisje elektronike	Pajisje zyre	Totali
Vlera bruto					
Më 1 janar 2013	**30,178,657**	**5,252,112**	**14,165,775**	**1,899,639**	**51,496,183**
Shtesat	706,908	647,171	1,426,117	234,039	**3,014,235**
Pakësimet/ transferimet	-	(154,810)	(31,338)	-	**(186,148)**
Diferencë këmbimi	1,117,480	213,007	575,869	77,113	**1,983,469**
Më 31 dhjetor 2013	**32,003,045**	**5,957,480**	**16,136,423**	**2,210,791**	**56,307,739**
Shtesat	993,262	549,873	1,718,619	260,759	**3,522,513**
Pakësimet/ transferimet	(559,675)	(59,565)	(89,038)	(47,464)	**(755,742)**
Diferencë këmbimi	(3,714,765)	(691,886)	(1,874,203)	(256,759)	**(6,537,613)**
Më 31 dhjetor 2014	**28,721,867**	**5,755,902**	**15,891,801**	**2,167,327**	**52,536,897**
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 1 janar 2013	**(8,437,448)**	**(3,902,425)**	**(9,747,902)**	**(1,239,624)**	**(23,327,399)**
Shpenzimi për vitin	(1,365,362)	(631,832)	(1,860,137)	(277,940)	**(4,135,271)**
Pakësimet / jashtë përdorimit	-	152,099	31,338	-	**183,437**
Diferencë këmbimi	(385,147)	(181,057)	(459,466)	(60,369)	**(1,086,039)**
Më 31 dhjetor 2013	**(10,187,957)**	**(4,563,215)**	**(12,036,167)**	**(1,577,933)**	**(28,365,272)**
Shpenzimi për vitin	(1,381,978)	(483,028)	(1,804,297)	(200,892)	**(3,870,195)**
Pakësimet / jashtë përdorimit	134,241	47,689	50,517	19,837	**252,284**
Diferencë këmbimi	1,300,928	572,546	1,554,695	201,515	**3,629,684**
Më 31 dhjetor 2014	**(10,134,766)**	**(4,426,008)**	**(12,235,252)**	**(1,557,473)**	**(28,353,499)**
Vlera e mbetur					
Më 1 janar 2013	**21,741,209**	**1,349,687**	**4,417,873**	**660,015**	**28,168,784**
Më 31 dhjetor 2013	**21,815,088**	**1,394,265**	**4,100,256**	**632,858**	**27,942,467**
Më 31 dhjetor 2014	**18,587,101**	**1,329,894**	**3,656,549**	**609,854**	**24,183,398**

Më 31 dhjetor vlera bruto e aktiveve të amortizuara plotësisht ishte 14,582,199 USD (2013: 14,584,516 USD).

16. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 përbëhen si më poshtë:

	Programe kompjuterike
Vlera bruto	
Më 1 janar 2013	**6,071,945**
Shtesat	444,654
Diferencë këmbimi	237,846
Më 31 dhjetor 2013	**6,754,445**
Shtesat	741,476
Diferencë këmbimi	(783,710)
Më 31 dhjetor 2014	**6,712,211**
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2013	**(4,557,034)**
Shpenzimi për vitin	(754,854)
Diferencë këmbimi	(206,868)
Më 31 dhjetor 2013	**(5,518,756)**
Shpenzimi për vitin	(659,619)
Diferencë këmbimi	696,754
Më 31 dhjetor 2014	**(5,481,621)**
Vlera e mbetur	
Më 1 janar 2013	**1,514,911**
Më 31 dhjetor 2013	**1,235,689**
Më 31 dhjetor 2014	**1,230,590**

Programet kompjuterike përfaqësohen kryesisht nga sistemet operative dhe kontabël të azhornuara të Bankës, si dhe nga liçenca dhe programet kompjuterike për sigurimin e shërbimeve të internetit dhe shërbimeve të bankingut elektronik. Në vitin 2011 Banka bleu module të rinj dhe filloi zbatimin e azhornimit të programit kompjuterik, që përfundoi në nëntor 2013.

17. Aktive të tjera

Aktivet e tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktive të përfituara nga proçesi ligjor	33,010,642	29,142,829
Çeqe për arkëtim	4,728,196	6,101,806
Kosto administrimi të arkëtueshme nga huamarrës	2,943,231	2,794,091
Çeqe për t'u marrë dhe pagesë në tranzit	1,851,531	2,087,473
Shpenzime të parapaguara	667,204	1,270,371
Inventare	441,316	847,030
Paradhënie për furnitorët	67,526	734,656
Fitimi nga rivlerësimi i kontratave të kursit të këmbimit	-	199,857
Debitorë të tjerë	750,976	3,469,321
	44,460,622	**46,647,434**

17. Aktive të tjera (vazhdim)

Aktive të përfituara nga proçesi ligjor përbëhen nga vlerat e kolateraleve të disa kredive të parikuperueshme, pronësia e te cilëve ka kaluar në emër të Bankës. Vlera e këtyre aktiveve afatgjata është rivlerësuar sistematikisht dhe Banka ka formuar Komitetin e Shitjeve të Aktiveve Afatgjata, i cili merret me proçesin e shitjes së këtyre aktiveve.

Vlera e drejtë e këtyre aktiveve afatgjata është përcaktuar duke marrë parasysh çmimet aktuale të tregut. Një numër pronash me vlerë kontabël 6,842,608 USD (2013: 7,613,994 USD) i janë dhënë me qera të tretëve dhe në vitin 2012 janë riklasifikuar nga prona dhe paisje në aktive të fituar nëpërmjet proçeseve ligjore (aktive afatgjata materiale të investuara). Shtesa e amortizimit e aktiveve të dhëna me qera për 31 dhjetor 2014 është 308,811 USD (31 dhjetor 2013: 200,209 USD). Rinovimet e mëvonshme janë negociuar me qeramarrësit mbi baza vjetore. Të ardhurat nga qeraja prej tyre në vlerën 294,937 USD (31 dhjetor 2013: 212,328 USD), janë njohur si të ardhura të tjera.

Çeqet për arkëtim dhe llogaritë pezull përfaqësojnë kryesisht çeqe të klientëve të lëshuar dhe pagesa të kryera në banka të tjera të cilat janë në proçesin e mbledhjes.

18. Detyrime ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2014	**31 dhjetor 2013**
Llogari rrjedhëse:		
Individë	147,787,286	111,149,607
Shoqëri private	183,734,188	162,266,836
Ndërmarrje shtetërore	28,994,235	21,859,942
	360,515,709	**295,276,385**
Depozita:		
Individë	1,609,357,547	1,668,832,778
Shoqëri private	96,578,848	110,693,639
Ndërmarrje shtetërore	39,765,264	47,354,847
	1,745,701,659	**1,826,881,264**
Të tjera:		
Individë	4,306,503	2,929,112
Shoqëri private	29,812,865	28,442,374
Ndërmarrje shtetërore	482,249	736,261
	34,601,617	**32,107,747**
	2,140,818,985	**2,154,265,396**

18. Detyrime ndaj klientëve (vazhdim)

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse paraqiten më poshtë sipas maturitet origjinal dhe monedhës:

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
	Në Lek	**Në valutë**	**Totali**	**Në Lek**	**Në valutë**	**Totali**
Llogaritë rrjedhëse	**170,575,363**	**189,940,346**	**360,515,709**	**127,997,416**	**167,278,969**	**295,276,385**
Depozita						
Pa afat	2,467,267	47,274,211	**49,741,478**	1,391,735	50,245,822	**51,637,557**
Me afat deri në 39 ditë	30,330,124	39,391,099	**69,721,223**	26,889,141	64,854,923	**91,744,064**
Me afat 40-99 ditë	57,743,082	53,519,314	**111,262,396**	65,817,946	94,202,623	**160,020,569**
Me afat 100-189 ditë	99,672,572	88,819,806	**188,492,378**	109,715,664	109,003,584	**218,719,248**
Me afat 190- 370 ditë	528,945,885	508,156,718	**1,037,102,603**	589,332,565	478,404,375	**1,067,736,940**
Me afat 371 ditë dhe më tepër	156,444,549	114,626,183	**271,070,732**	123,750,029	83,553,438	**207,303,467**
Interesi i përllogaritur	12,960,878	5,349,971	**18,310,849**	22,036,360	7,683,059	**29,719,419**
Totali i depozitave	**888,564,357**	**857,137,302**	**1,745,701,659**	**938,933,440**	**887,947,824**	**1,826,881,264**
Llogari të tjera	**13,887,507**	**20,714,110**	**34,601,617**	**10,375,296**	**21,732,451**	**32,107,747**
Totali i detyrimeve ndaj klientëve	**1,073,027,227**	**1,067,791,758**	**2,140,818,985**	**1,077,306,152**	**1,076,959,244**	**2,154,265,396**

Llogaritë e tjera të klientëve janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2014			31 dhjetor 2013		
	Në Lek	**Në valutë**	**Totali**	**Në Lek**	**Në valutë**	**Totali**
Depozita garancie për letër kreditë	1,342,970	9,729	**1,352,699**	-	1,464,517	**1,464,517**
Llogari për mbulim garancie	7,188,500	14,908,007	**22,096,507**	5,994,544	14,395,580	**20,390,124**
Urdhër pagesa për t'u kryer	199,603	54,516	**254,119**	223,380	663,597	**886,977**
Të tjera	5,156,434	5,741,858	**10,898,292**	4,157,372	5,208,757	**9,366,129**
	13,887,507	**20,714,110**	**34,601,617**	**10,375,296**	**21,732,451**	**32,107,747**

Depozita garancie për letër kreditë përfaqësojnë garancitë në para të mbajtura nga Banka përkundrejt të njëjtës garanci të ofruar nga BKT ndaj bankave korrespondente për letër kreditë e hapura në favor të klientëve të saj.

Teprica e llogarive për mbulim garancie përfaqëson shuma të bllokuara deri në përfundimin e një veprimi ose të zhdukjes së një rreziku. Shumat e regjistruara në këto llogari lidhen kryesisht me mbulesa në para të marra nga klientët për garancite e ofertës ose të kontratës së lëshuar nga Banka ose për veprimet me bonot e thesarit që kryhen me Bankën e Shqipërisë, të cilat ndërmjetësohen nga Banka.

Të tjerat përfaqësojnë depozitat e mbetura në pritje për t'u shpërndarë në kategorinë përkatëse të depozitave me afat ditën tjetër të punës (datë valutë).

19. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Detyrimet ndaj bankave më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 përbëhen nga sa më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Bono thesari të shitura me marrëveshje Repo me Bankën Qendrore	170,366,559	160,008,842
Letra me vlerë të shitura për marrëveshjet Repo	46,024,913	6,551,212
Depozita nga bankat	80,285,835	77,885,797
Llogari rrjedhëse të bankave jo rezidente	3,386,664	4,851,687
Llogari rrjedhëse të bankave rezidente	2,912	5,117
Hua nga institucionet financiare	26,847,569	29,053,168
	326,914,452	**278,355,823**

Bonot e thesarit dhe bondet e Qeverisë së Shqipërisë me një vlerë prej 257,707,689 USD (2013: 205,487,925 USD), jane përdorur si garanci për marrëveshjet Repo me Bankën Qendrore dhe huamarrjet nga bankat.

Depozitat nga bankat në 31 dhjetor 2014, përfaqësojnë huamarrjet afat-shkurtra të marra nga bankat rezidente dhe jorezidente.

Huamarrje nga institucionet financiare përfaqëson huamarrjen shtatë vjecare prej 22,075,392 EUR (2013: 21,108,100 EUR), marrë nga Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) për dhënien e huave tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, klientë të Bankës. Pjesë e kësaj huaje më 31 dhjetor 2014 janë edhe dy këstet prej 5,000,000 EUR secili lëvruar në dhjetor 2013 dhe qershor 2014, sipas marrëveshjes së re nënshkruar më 13 dhjetor 2013.

20. Detyrime ndaj palëve të treta

Banka luan rolin e agjentit për autoritetet fiskale, duke arkëtuar taksat ose duke kryer paradhënie për buxhetin. Në këmbim Banka mban një komision prej taksapaguesve për shërbimin e ofruar. Balanca në 31 dhjetor 2014 prej 2,123,604 USD (2013: 1,738,013 USD) përfaqëson balancën neto të pagesave dhe arkëtimeve bërë nga Banka për dhe nga palët e treta, në emër te autoriteteve fiskale.

21. Detyrime tatimore të shtyra

Tatimet e shtyra janë llogaritur mbi gjithë ndryshimet e përkohshme sipas metodës së detyrimeve duke përdorur normën e taksës prej 15% (2013: 10%). Lëvizjet ne llogarinë e tatimeve të shtyra paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Gjëndja më 1 janar	3,264,859	1,978,653
Shpenzimi i regjistruar	550,014	1,523,522
Rimarrja për vitin	(1,542,906)	(358,293)
Diferenca këmbimi	(425,356)	120,977
Gjëndja në fund të vitit	**1,846,611**	**3,264,859**

(Aktivet)/Detyrimet tatimore të shtyra lidhen me zëra që paraqiten më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
E ardhura e shtyrë nga komisioni i kredive	(635,626)	(415,258)
Zhvlerësim i ngadalësuar i aktiveve afatgjata	(681,142)	(485,003)
Fondi i zhvlerësimit për huatë	2,279,338	3,178,313
Rezerva e vlerës së tregut të letrave me vlerë të mbajtura për shitje	884,041	986,807
	1,846,611	**3,264,859**

Mbështetur në Ligjin për kontabilitetin, duke filluar nga data 1 janar 2008, Banka duhet të raportojë në përputhje me SNRF. Ligji Nr. 10364, datë 16.12.2010, paraqet ndryshime, (të cilat janë në fuqi që nga 24 janar 2011). Bazuar në këto ndryshime, fondi për zhvlerësim për kreditë, që mbahet nga Banka në përputhje me SNRF, do të konsiderohet si shpenzim i zbritshëm, nëse është çertifikuar nga auditorët e jashtëm dhe nuk kalon limitet e përcaktuara nga Banka e Shqipërisë. Me paketën e re fiskale që hyri në fuqi më 1 janar 2014, shpenzimi i zbritshëm për fondin për zhvlerësim është i barabartë me fondin per zhvlerësim sipas SNRF-ve, prandaj, diferencat e përkohshme të njohura më parë në lidhje me fondin për zhvlerësimin e kredive për qëllime të raportimit financiar dhe për qëllime tatimore në Shqipëri, janë rimarrë dhe janë kontabilizuar si "Rimarrje e diferencave të përkohshme të pagueshme ndaj organeve tatimore" (shih gjithashtu shënimin 22 "Detyrime të tjera").

22. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Detyrime ndaj autoriteteve tatimore	3,693,208	1,013,325
Rimarrje e diferencave të përkohshme të pagueshme ndaj organeve tatimore	1,542,906	-
Shpenzime të përllogaritura	2,031,882	591,173
Kreditorët	1,837,884	1,814,041
Bonus i pagueshëm	1,407,838	1,111,939
Sigurimi i depozitave për t'u paguar	1,273,009	1,345,918
Llogaritë tranzitore	1,136,111	731,545
Humbja nga rivlerësimi i kontratave të kursit të këmbimit	1,075,340	573,908
Fondi rezervë për pensionin e punonjësve (shënimi 3(r).ii.)	1,052,803	1,099,870
Detyrime ndaj ndërtuesve për kredi për shtëpi	660,026	812,172
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore	181,488	170,516
Garanci në para nga furnitorët	102,404	91,027
	15,994,899	**9,355,434**

22. Detyrime të tjera (vazhdim)

Kreditorët përfshijnë shuma prej 1,837,884 USD (2013: 1,814,041 USD) nga transaksionet e vjetra që Qeveria Shqiptare i mban me Bankën, në pritje të caktimit të pronarit të ligjshëm të këtyre shumave, në të ardhmen.

Bonusi për t'u paguar përfaqëson shumat e përllogaritura të shpërblimit të performancës vjetore për menaxhimin dhe punojësit, që janë planifikuar për t'u paguar në tremujorin e parë të vitit 2015.

Detyrimi ndaj sigurimit të depozitave lidhet me tremujorin e fundit të vitit 2014 dhe është i pagueshëm në përputhje me Ligjin nr. 8873, datë 29 mars 2002 "Për Sigurimin e Depozitave", i cili u ofron depozituesve individë sigurim përkundrejt falimentimit të bankave.

23. Borxhi i varur

Borxhi i varur prej 18,287,260 USD (2013: 13,796,864 USD) përfaqëson vlerën ekuivalente të 10 milion Euro, të përfituara nga Green for Growth Fund Southeast Europe, sipas marrëveshjes së Borxhit të varur, nënshkruar më 19 nëntor 2012 me synim ofrimin e kredive të lidhura me investime në fushën e Efiçencës Energjitike dhe Energjisë së Rinovueshme. Lëvrimi i këstit të dytë të borxhit prej 5 milion EUR u krye më 1 korrik 2014.

Në vijim të miratimeve të marra nga Banka e Shqipërisë, borxhi i varur është klasifikuar si kapital shtesë dhe është përfshirë në kapitalin rregullator të Bankës.

24. Kapitali aksionar i paguar dhe rezervat

Kapitali i aksionar i paguar

Më 31 dhjetor 2014 kapitali aksionar është i përbërë nga 13,474,000 aksione të zakonshme (2013: 11,252,300). Aksionet kanë një vlerë nominale prej 12.35 USD. Të gjitha aksionet janë të paguara plotësisht. Aksionarët kanë të drejtën e përfitimit të dividendit kur ai deklarohet. Të gjitha aksionet e Bankës renditen si të njëjta në lidhje me aktivet e mbetura të Bankës.

Rezerva ligjore

Sikurse përshkruhet në Shënimin 1, në bazë të Vendimit të Aksionarëve të marrë në datën 25 mars 2014 Banka krijoi rezervën ligjore prej 747,430 mije Lek (ekuivalenti në 7,355,870 USD).

Totali i rezervës ligjore të krijuar u përdor në rritjen e kapitalit të paguar më 17 Tetor 2014. Më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 nuk ka patur rezervë ligjore.

Rezerva e konvertimit

Rezerva e konvertimit përfshin të gjitha diferencat e këmbimeve valutore që lindin nga konvertimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja sikurse edhe nga konvertimi i pasqyrave financiare të konsoliduara nga monedha funksionale në monedhën e prezantimit.

Rezerva e vlerës së drejtë

Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin neto kumulativ në vlerën e drejtë të investimeve të mbajtura për shitje, duke përjashtuar humbjet nga rënia në vlerë, derisa investimi çregjistrohet ose zhvlerësohet.

Fitimi i pashpërndarë

Fitimi i pashpërndarë më 31 dhjetor 2014 përfshin fitimin e akumuluar të pashpërndarë. Sikurse përshkruhet në Shënimin 1, Banka përdori një pjesë të fitimit të saj të pashpërndarë prej 2,238,647 mije Lek (ekuivalente e 20,570,127.89 USD) për të rritur kapitalin e saj të paguar më 17 tetor 2014.

25. Të ardhura nga interesi

Të ardhurat nga interesi përbëhen nga:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Depozita me bankat dhe Bankën Qendrore	6,256,799	6,632,818
Bono thesari dhe letra me vlerë	64,129,494	63,898,103
Hua për klientët	73,376,371	81,408,161
	143,762,664	**151,939,082**

E ardhura nga interesi mund të analizohet si me poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim	15,686,161	20,422,374
Aktivet financiare të mbajtura për shitje	54,700,132	50,108,547
Hua dhe të arkëtueshme	73,376,371	81,408,161
	143,762,664	**151,939,082**

Të ardhurat nga interesi për kreditë e zhvlerësuara individualisht për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 ishin 15,409 USD (2013: 309,722 USD).

26. Shpenzime interesi

Shpenzimet e interesit lidhur me detyrimet financiare, vlerësuar me koston e amortizuar, paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	9,228,971	10,648,766
Detyrime ndaj klientëve	44,704,336	64,375,312
	53,933,307	**75,024,078**

27. Tarifa dhe komisione, neto

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet përbëhen nga zërat e mëposhtëm:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		
Shërbimet e pagesave për klientë	4,384,846	3,991,684
Veprime me banking elektronik	2,237,209	1,834,994
Veprime ndër bankare	2,208,399	1,809,562
Mirëmbajtja e llogarive të klientëve	1,589,909	1,421,280
Aktiviteti i huadhënies	1,407,989	1,112,353
Veprime me para në dorë me klientët	350,523	327,186
Tarifa dhe komisione të tjera	169,602	251,112
	12,348,477	*10,748,171*
Shpenzimet për tarifa dhe komisione		
Veprime ndërbankare	(505,148)	(1,062,395)
Mbajtja e llogarive bankare të klientëve	(103,893)	(98,014)
Veprime me klientët	(71,645)	(947)
Shërbimet e pagesave bankare të klientëve	(34,148)	(29,367)
Tarifa dhe komisione të tjera	(1,755)	(40)
	(716,589)	*(1,190,763)*
Tarifa dhe komisione, neto	**11,631,888**	**9,557,408**

28. Fitimi (humbja) neto nga rivlerësimi i instrumentave monetare

Fitimi neto nga rivlerësimi i valutave përfaqëson rivlerësimin prej kursit të këmbimit, të aktiveve dhe detyrimeve monetare të Bankës në monedhë të huaj. Ashtu si është përshkruar në Shënimin 3(b), ai përfshin gjithashtu lëvizjen e rivlerësimit të kapitalit të paguar. Fitimi nga rivlerësimi i kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është 17,282,439 USD (2013: 6,516,342 USD).

29. Të ardhura/(shpenzime) të tjera, neto

Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	**Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013**
Të ardhura të tjera		
E ardhura neto nga instrumentet financiare të matur me vlerën e tregut	1,856,434	8,490,428
Të ardhurat nga dividendët nga investimet në kapital	1,479,184	2,179,905
Fitimi nga provizioni i debitorëve të tjerë	309,752	-
E ardhura nga qiraja operacionale	294,937	212,328
Fitimi nga shitja e aktiveve të trupëzuara	98,341	25,936
Fitimi nga shitja e aktiveve përfituar nga proçesi ligjor	31,336	95,933
Fitimi nga arkëtimi i kredive të fshira të klientëve	15,633	40,425
Pakësimi i fondit të pensioneve të stafit	14,322	70,234
Të tjera	18,992	53,558
	4,118,931	*11,168,747*
Shpenzime të tjera		
Fshirja e kredive të klientëve	(157,905)	(24,068)
Humbje nga shitja ose fshirja e aktiveve të trupëzuara	(40,738)	(2,594)
Provizioni i debitorëve të tjerë	-	(332,379)
Të tjera	(67,263)	(65,963)
	(265,906)	*(425,004)*
Shpenzime të tjera, neto	**3,853,025**	**10,743,743**

30. Shpenzime Personeli

Shpenzimet e personelit përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	**Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013**
Pagat	14,312,836	13,526,579
Shpërblime për performancën	1,718,487	1,366,251
Sigurimet shoqërore	1,379,415	1,250,158
Trajnime	504,049	518,890
Sigurimi i jetës	175,964	137,748
Të tjera	522,130	305,512
	18,612,881	**17,105,138**

31. Shpenzime Administrative

Shpenzimet administrative përbëhen nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Shpenzime për sigurimin e depozitave	5,784,808	5,370,057
Shpenzime për karta debiti/krediti	2,863,859	2,454,490
Pagesa qeraje	2,854,735	2,580,707
Shpenzime telefoni, energjie dhe IT	2,539,995	2,534,039
Riparime dhe mirëmbajtje	2,100,792	1,940,421
Shpenzime marketingu	1,983,596	2,213,344
Shpenzime ruajtje dhe sigurimi	1,073,439	1,098,598
Shpenzime transporti dhe udhëtimi për punë	962,171	906,759
Shërbime të tjera (përfshi auditimin e jashtëm)	845,890	383,437
Kancelari dhe mjete të tjera zyre	479,310	488,529
Shpenzime përfaqësimi	250,325	257,991
Taksa të tjera përveç tatimit mbi fitimin	201,093	153,412
Të tjera	850,065	592,820
	22,790,078	**20,974,604**

32. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga sa më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Tatimi mbi fitimin e vitit	8,394,748	3,365,501
Shpenzimi/(e ardhura) i shtyrë tatimor (shënimi 21)	550,014	1,523,522
Tatimi i shtyrë i njohur në tatimin aktual (shënimi 21)	-	(358,293)
	8,944,762	**4,530,730**

Tatimi mbi fitimin para tatimit ndryshon nga shuma teorike që do të rezultonte nga përdorimi i normës bazë të taksës:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	**52,875,658**	**43,833,483**
Llogaritur me normën tatimore prej 15 % (2013: 10%)	7,931,349	4,383,348
Shpenzimet e pazbritshme	333,002	536,762
Detyrim i akumuluar i tatimit të shtyrë me 15%	733,644	-
Tatimi i shtyrë i njohur në tatimin aktual	-	(358,293)
Diferenca nga kursi	(53,233)	(31,087)
Tatimi mbi fitimin	**8,944,762**	**4,530,730**
Norma efektive e tatimit	**16.92%**	**10.34%**

33. Veprimet me palët e lidhura

Identiteti i palëve të lidhura

Në përputhje me SNK 24 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura", një palë e lidhur është çdo palë që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër, ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Banka ka marrëdhënie si palë e lidhur, me aksionarët e saj, njësi të lidhura brenda të njëjtit grup, drejtorët dhe zyrtarët ekzekutivë. Aksionari i vetëm i Bankës është Çalik Finansal Hizmetler, i cili zotërohet nga Çalik Holding në masën 100% në 31 dhjetor 2014. Pala kontrolluese përfundimtare është Z. Ahmet Calik.

ALBtelecom Sh.a., Eagle Mobile Sh.a., Aktif Yatirim Bankasi A.S. (“Aktifbank”), GAP Pazarlama FZE, Gap İnşaat Yatırım ve Dış Ticaret A.Ş., Calik Elektrik Dagitim A.S and Calik Enerji Sanayi Ve. Ticaret A.S dhe Kosovo Electricity Distribution and Supply Company J.S.C (KEDS) kontrollohen nga Çalik Holding. Asyatek San.Tic.Ltd.Sti dhe Anateks Anadolu Tekstil Fab. Tic. janë kompani të kontrolluar nga individë me lidhje të ngushta familjare me pronarin e Çalik Holding.

Balancat dhe veprimet me palët e lidhura

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktivet		
Depozita dhe llogaritë me bankat:		
Llogarite rrjedhese me Aktifbank	124,482	88,290
Depozita me Aktifbank	-	12,054,618
Letrat me vlerë të vlefshme për shitje:		
Aktifbank	-	40,852,295
Hua për klientët:		
KEDS	1,651,098	1,854,163
ALBtelecom	3,710,250	-
GAP Pazarlama FZE	8,246,932	-
Gap İnşaat Yatırım ve Dış Ticaret A.Ş.	3,046,522	-
Asyatek San.Tic.Ltd.Sti	495,011	-
Aktive të tjera:		
Të arkëtueshme nga ALBtelecom Sh.a	-	11,035
Totali i aktiveve	**17,274,295**	**54,860,401**
Detyrimet		
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare:		
Huamarrje nga Aktifbank	3,357,255	11,199,412
Detyrime ndaj klientëve:		
ALBtelecom Sh.a.	764,618	4,112,346
Eagle Mobile Sh.a.	-	24
Detyrime të tjera:		
Detyrime për ALBtelecom Sh.a	153,106	67,793
Detyrime për Calik Holding	186,657	-
Totali i detyrimeve	**4,461,636**	**15,379,575**

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara		
Garanci në favor të klientëve:		
KEDS	2,420,001	7,163,046

33. Veprimet me palët e lidhura (vazhdim)

	2014	2013
Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave		
Të ardhura të interesit nga:		
Aktifbank	1,127,067	1,578,254
GAP Pazarlama FZE	221,547	-
Anateks Anadolu Tekstil Fab. Tic.	-	401,476
KEDS	167,063	5,031
ALBtelecom Sh.a.	160,442	-
Gap İnşaat Yatırım ve Dış Ticaret A.Ş.	73,634	-
Asyatek San.Tic.Ltd.Sti	9,312	-
Shpenzime interesi për:		
ALBtelecom Sh.a. dhe Eagle Mobile Sh.a.	(30,311)	(80,781)
Aktifbank	(96,986)	(70,700)
Tarifa dhe komisione:		
Leter Garanci:		
ALBtelecom Sh.a.	244	290
Calik Elektrik Dagitim A.S dhe Calik Enerji Sanayi Ve. Ticaret A.S	-	11,203
KEDS	23,138	50,520
Mbajtja e llogarive bankare dhe komisione te kredive te ALBtelecom Sh.a. dhe Eagle Mobile Sh.a.	2,012	814
Të ardhura të tjera:		
Qera operacionale nga ALBtelecom Sh.a.	80,272	20,501
Shpenzime Operative		
ALBtelecom Sh.a., Eagle Mobile Sh.a. dhe Calik Holding	(1,071,354)	(1,141,607)
Neto	**666,080**	**775,001**

Balanca dhe veprime me drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë

Shpërblimi i drejtorëve dhe drejtuesve ekzekutivë përshihet në shpenzimet e personelit. Detajet paraqiten më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Drejtorët	129,158	118,650
Drejtuesit ekzekutivë	3,116,606	2,699,641
	3,245,764	**2,818,291**

Më 31 dhjetor 2014, depozitat totale të drejtorëve pranë Bankës ishin 822,071 USD (31 dhjetor 2013: 1,015,441 USD), ndërsa nuk ka teprica huash të dhëna drejtorëve.

34. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Garancitë dhe letrat e kreditit

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Garanci në favor të klientëve	63,203,153	115,317,133
Garanci të marra nga institucionet e kreditit	20,961,945	37,502,568
Letër kreditë e lëshuara për klientët	12,090,058	6,303,982

Garancitë dhe letër kreditë e dhëna në favor të klientëve janë kryesisht të kundër-garantuara nga institucione të tjera financiare ose janë plotësisht të garantuara në para.

34. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

Aktualisht Banka operon si një agjente për Qeverinë në administrimin e disa huave të marra nga disa ndërmarrje shtetërore, duke përdorur linja krediti të hapura nga donatorë ndërkombëtarë. Këta donatorë kanë marrë garanci individuale nga Qeveria e Shqipërisë për mbulimin e rimbursimit të linjave të tyre të kreditit.

Të tjera

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Angazhime për të dhënë kredi	124,572,829	69,075,578
Çeqe të bankave jo rezidente	283,546	238,407
Kontratat e kursit të këmbimit	265,549,672	282,725,222
Garanci për portofolin e kredive	2,250,055,341	2,379,195,755
Letra me vlerë si kolateral (shënimi 19)	257,707,689	205,487,925

Çështje ligjore

Në proçesin normal të aktivitetit Banka është përballur me çështje dhe konflikte gjyqësore; drejtuesit e Bankës janë të mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me çështjet ligjore të hapura deri më 31 dhjetor 2014.

Angazhime qiraje

Këto angazhime për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Jo më shumë se 1 vit	2,417,153	2,461,708
Nga 1 vit deri në 5 vjet	6,042,645	7,371,947
Më shumë se 5 vjet	1,335,122	1,724,639
Totali	**9,794,920**	**11,558,294**

Banka ka hyrë në angazhime qiraje për të gjitha degët dhe agjencitë e hapura gjatë viteve 2003-2014 me një afat maksimal prej 10 vjetësh.

Banka ka 81 ndërtesa me qira në datën 31 dhjetor 2014, në të cilat është përfshirë ambienti i dedikuar jashtë Bankës që do të përdoret në rast katastrofe dhe 25 ndërtesat e marra me qira për njësitë e Degës së Kosovës.

Banka mund t'i anullojë këto marrëveshje qiraje duke dhënë njoftim para 3 muajsh. Në 31 dhjetor 2014, angazhimi maksimal dhe i pandryshueshëm, i pagueshëm brenda vitit është 604,288 USD (2013: 615,427 USD).

Banka, një pjesë të pronave e jep me qera, duke aplikuar qeranë operative për një periudhe 1 vjeçare, me opsionin e rinovimit pas kësaj periudhe.

35. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë sistemime ose shpjegime shtesë në pasqyrat financiare të konsoliduara.